RIINVEST
INSTITUTI PËR HULUMTIME ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

FORUMI EKONOMIK VJETOR

PËRTEJ RRITJES EKONOMIKE: SFIDAT DEMOGRAFIKE TË KOSOVËS

NËNTOR, 2026



FORUMI EKONOMIK VJETOR

PËRTEJ RRITJES EKONOMIKE: SFIDAT DEMOGRAFIKE TË KOSOVËS

PËRGATITUR NGA:

Alban Hashani – Drejtor Ekzekutiv, udhëheqës i projektit
Muhamet Mustafa – Këshilltar Senior, koordinator i projektit
Alma Bajramaj
Benet Maloku
Bujar Pira
Erisa Kallaba- Krasniqi
Halim Mahmuti
Mentor Geci
Pellumb Çollaku
Petrit Gashi
Tringë Shkodra
Valentin Toçi
Vesa Arifi
Visar Vokrri

BOTUAR NGA:

INSTITUTI RIINVEST
Andrea Gropa Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320;
www.riinvestinstitute.org

MBËSHTETUR NGA:

OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS
WESTERN BALKANS

Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve. Instituti Riinvest merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

E drejta autoriale © 2026 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistrues apo tjetër, pa e cituar burimin.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME 8

HYRJE 12

1. RTIJA EKONOMIKE DHE BALLFAQIMET GJEOPOLTIKE DHE TEKNOLOGJIKE 14

1.1 Zhvillimet në rrafshin global 14
1.2 Ballkani Perëndimor (BP) 16

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË KOSOVË 20

2.1. Dinamika e rritjes ekonomike dhe problemet shoqëruese 20
2.2. Inflacioni dhe shkëndijat e tij nga jashtë e brenda 22
2.3 Sektori i jashtëm 25
2.4 Sektori financiar 29
2.5 Shpenzimet qeveritare 34

3. MJEDISI BIZNESOR 42

4. TRANSFORMIMI DEMOGRAFIK DHE IMPLIKIMET PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS 48

4.1. Transformimi demografik i Kosovës: popullsia, plakja dhe migrimi 48
4.2. Implikimet ekonomike: oferta e punës, pjesëmarrja dhe produktiviteti 51
4.3. Perspektiva demografike dhe përgjigjet e politikave ekonomike 55

REFERENCAT 58

Lista e shkurtesave

ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BP	Ballkani Perëndimor
BPV / PVB	Bruto Produkti Vendor / Produkti Vendor Bruto
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CBAM	Mekanizmi i Rregullimit të Karbonit në Kufij
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
COICOP	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development
EFTA	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
ELMA	Employment and Labour Market Analysis (Analiza e Punësimit dhe Tregut të Punës)
FEG	Forumi Ekonomik i Grave
FEV	Forumi Ekonomik Vjetor
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GEGI	Indeksi i Hendekut Gjinor në Punësim
IA	Inteligjenca Artificiale
ICT	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IJD	Investimet e Huaja Direkte
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
MF	Ministria e Financave
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSF-WB	Open Society Foundations – Western Balkans
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
ROA	Kthimi në Asete (Return on Assets)
ROE	Kthimi në Kapital (Return on Equity)
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
TM	Tremujori
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
wiiw	Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

Lista e Tabelave

Tabela 1: Projeksionet për rritjen globale dhe rajonale ekonomike (%)	15
Tabela 2: Parashikimi i rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor (%)	17
Tabela 3: Parashikimet e rritjes ekonomike në Kosovë (%)	20
Tabela 4: Eksporti dhe importi i mallrave 2019-2026	26
Tabela 5: Eksporti dhe importi i shërbimeve 2019-2026	27
Tabela 6: Statistika të sektorit të jashtëm të Kosovës	28
Tabela 7: Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore (miliarda euro)	35
Tabela 8: Struktura e të hyrave buxhetore (miliona euro)	36
Tabela 9: Struktura e shpenzimeve buxhetore	37
Tabela 10: Buxhetimi dhe realizimi i investimeve kapitale (milion euro)	38
Tabela 11: Buxheti për shëndetësi dhe Arsim (milion)	39
Tabela 12: Perceptimi i bizneseve për pengesat e të bërit biznes	44

Lista e Figurave

Figura 1: Kosova, Ballkani Perëndimor dhe BE: vendi me inflacionin më të ulët, mesatarja, dhe tre vendet me inflacionin më të lartë.	23
Figura 2: Indikatorët e likuiditetit dhe raporti kredi/depozitë për bankat komerciale, periudha 2019-2026	30
Figura 3: Rritja vjetore e kredive dhe depozitave gjatë periudhës 2020-2026 (në %)	31
Figura 4: Normat e interesit të kredive dhe depozitave, periudha 2019-2026 (në %)	32
Figura 5: Indikatorët e performancës së Fondeve Pensionale, analizë krahasuese Shtator 2025/2026, (në %)	33
Figura 6: Piramidat demografike të Kosovës, 2011 dhe 2024	49

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Në planin global, ekonomia po vazhdon rimëkëmbjen pas tronditjeve të mëdha që kanë filluar gjashtë vite më parë. Megjithatë, kjo rimëkëmbje po shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme dhe me pakësimin e rezervave fiskale dhe të burimeve të tjera për përballimin e çrregullimeve të reja. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), rritja ekonomike globale pritet të përmirësohet nga 3.1 për qind këtë vit në 3.4 për qind në vitin 2027. Presionet inflacioniste, ndonëse me intensitet më të ulët, pritet të vazhdojnë edhe gjatë vitit të ardhshëm. Kushtet globale të afarizmit po ndikohen gjithnjë e më shumë nga tri transformime të thella: ndryshimet gjeopolitike dhe ekonomike, transformimi teknologjik i nxitur veçanërisht nga inteligjenca artificiale (IA), si dhe ndryshimet në organizimin dhe mënyrën e kryerjes së punës. Këto zhvillime po sfidojnë strukturat ekzistuese të biznesit dhe po krijojnë presion për inovacion, rritje të produktivitetit dhe fleksibilitet më të madh organizativ, si parakushte për ruajtjen dhe forcimin e aftësisë konkurruese. Në këtë kontekst, bizneset që integrojnë IA-në në të gjitha funksionet e tyre dhe investojnë në teknologji e kapital njerëzor pritet të kenë përparësi.

Pas ngadalësimit të rritjes ekonomike gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024, këtë vit është shënuar një përmirësim i ritmit të rritjes. Sipas vlerësimeve të FMN-së, Bankës Botërore (BB), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), rritja reale ekonomike e Kosovës për vitin 2026 pritet të jetë në intervalin 3.5–3.8 për qind. Kosova vazhdon të ruajë një dinamikë rritjeje më të shpejtë krahasuar me vendet fqinje, e ndjekur më afër nga Serbia dhe Shqipëria. Sipas parashikimeve të Institutit Riinvest, kjo dinamikë pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027, me një përmirësim të lehtë të rritjes ekonomike nga 3.5 për qind këtë vit në 3.7 për qind vitin e ardhshëm. Këto parashikime mbështeten në supozimin se do të vazhdojë konsolidimi i rritjes së eksporteve, krahas përmirësimit të realizimit të investimeve publike dhe shfrytëzimit të mundësive për investime që ofron Plani i Rritjes i BE-së. Vlerësimet tona janë të përafërta me ato të FMN-së dhe Bankës Botërore, me dallime prej 0.1–0.2 pikë përqindje, të cilat mund të shpjegohen pjesërisht me përfshirjen e të dhënave më të fundit në modelin tonë.

Kushtet më të shtrënguara financiare, kostot e larta të energjisë dhe pasiguria gjeopolitike mbeten rreziqe për kërkesën, investimet dhe flukset financiare nga diaspora. Ngjashëm me vendet e rajonit, por në një shkallë edhe më të theksuar, rritja e konsumit në Kosovë gjeneron kërkesë të lartë për importe, duke krijuar një cikël të pafavorshëm për zhvillimin e ekonomisë vendore. Megjithatë, sektori i jashtëm shënoi zhvillim pozitiv, i nxitur nga trendi konjunktural në sektorin e metaleve dhe mineraleve, i cili u reflektua në rritjen e eksportit për 22.4% deri në fund të shtatorit. Kjo e përmirësoi raportin eksport-import nga 12% në 13.7%. Megjithatë, për shkak të lëvizjeve në komponentët e tjerë, deficiti në bilancin e pagesave u rrit nga 13.5% në 14.6% të PVB-së. Investimet e huaja direkte vazhduan trendin rritës, por me një strukturë ku dominojnë patundshmëritë, me afro 66.4% të totalit, ndërkohë që remitancat mbetën në nivelin e vitit të kaluar (më gjerësisht për këtë sektor shihni pjesën 2.3).

Shpenzimet qeveritare, përkatësisht ato buxhetore, po karakterizohen nga një ngadalësim i konsiderueshëm i ritmit të rritjes nominale, i cili pothuajse është përgjysmuar, ndërsa në terma realë ato mbeten afërsisht në nivelin e vitit të kaluar. Një dinamikë e ngjashme pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027 (më gjerësisht për këtë sektor shihni pjesën 2.5). Kontributi i buxhetit në rritjen ekonomike do të mund të ishte dukshëm më i madh nëse do të përmirësohej shkalla e realizimit të investimeve kapitale. Krahas kësaj, nevojitet një riorientim i prioriteteve

buxhetore për të përmirësuar pozitën e arsimit, shëndetësisë, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Sipas projeksioneve buxhetore për vitin 2027, financimi i këtyre sektorëve mbetet pothuajse i pandryshuar dhe dukshëm më i pafavorshëm krahasuar me vendet e rajonit. Kjo përbën një nga kufizimet thelbësore për përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe kërkon trajtim me prioritet. Raporti nëntëmujor i realizimit të buxhetit për vitin 2026 evidenton gjithashtu një nivel të ulët të realizimit të investimeve kapitale, me një rënie prej 3 pikë përqindje krahasuar me periudhën përkatëse të vitit të kaluar. Shqetësues mbetet edhe fakti se kjo kategori buxhetore ngarkohet me shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të cilat përbëjnë 21.8 për qind të totalit të shpenzimeve kapitale.

Inflacioni pritet të ngadalësohet gjatë vitit 2027, pas presioneve të theksuara gjatë këtij viti, kur në tetor norma vjetore arriti në 7.1 për qind. Megjithatë, inflacioni në Kosovë pritet të mbetet mbi nivelin mesatar të vendeve të rajonit. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) parashikon një normë inflacioni prej rreth 4.5 për qind për vitin 2027, ndërsa FMN-ja vlerëson një normë prej 3–3.6 për qind për vendet e rajonit. Kostot e energjisë elektrike, përfshirë efektet e mundshme të shtyra në vitin 2027, kushtet e sezonit dimëror, zhvillimet e pagave, politika fiskale ekspansioniste dhe pasiguria politike paraqesin rreziqe për realizimin e këtyre parashikimeve. Shqetësim i veçantë mbetet jo vetëm niveli i inflacionit, por edhe qëndrueshmëria e presioneve inflacioniste, në kushtet e mungesës së masave më efektive për zbutjen e tyre.

Në sektorin financiar është evidentuar një ngadalësim i ritmit të rritjes së kreditimit krahasuar me dy vitet paraprake, i shoqëruar me dobësim të kërkesës për kredi. Këto zhvillime kanë ndodhur në kushtet kur norma mesatare e interesit është rritur në 6.9 për qind gjatë këtij viti. Në anën tjetër, depozitat kanë vazhduar të rriten, madje me një ritëm pak më të lartë se në vitin paraprak.

Rezultatet e anketës së Institutit Riinvest tregojnë gjithashtu një përkeqësim të perceptimeve të bizneseve lidhur me pengesat në zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Rritje e konsiderueshme e intensitetit të pengesave të perceptuara është evidentuar veçanërisht në furnizimin me energji elektrike, sigurimin e fuqisë punëtore, qasjen në financim dhe korrupsionin. Në anën tjetër, përmirësime janë shënuar në disa prej pengesave administrative. Këto zhvillime tregojnë se, krahas përmirësimit të kuadrit rregullator, rëndësi gjithnjë e më të madhe po marrin kufizimet që lidhen me koston dhe disponueshmërinë e faktorëve të prodhimit.

Në përgjithësi, struktura e buxhetit dhe orientimi i politikave ekonomike ende nuk pasqyrojnë një qasje të mjaftueshme zhvillimore, të mbështetur në politika industriale dhe masa që u përgjigjen nevojave dhe nivelit të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës. Një qasje e tillë duhet të synojë kalimin gradual drejt një modeli të rritjes ekonomike që mbështetet më shumë në zgjerimin e ofertës vendore të produkteve dhe shërbimeve konkurruese, si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Kjo e rikthen në qendër të vëmendjes domosdoshmërinë e rritjes së investimeve në arsim, shëndetësi, kërkim shkencor dhe inovacion, si parakushte për zhvillimin e kapitalit njerëzor, rritjen e produktivitetit dhe përshpejtimin e konvergjencës ekonomike.

Një vëmendje e veçantë në raportin e sivjetmë i kushtohet tranzicionit demografik dhe ndikimit të tij në perspektivën zhvillimore të Kosovës. Vendi po kalon gradualisht nga një strukturë demografike relativisht e re drejt një situate me rritje më të ulët natyrore, emigrim të vazhdueshëm dhe plakje të popullsisë. Popullsia rezidente është zvogëluar nga rreth 1.74 milion banorë në vitin 2011 në rreth 1.60 milion në vitin 2024, trend i cili vijoi edhe në vitin 2025, ndërsa pjesëmarrja e personave të moshës 65 vjeç e më shumë është rritur nga 6.7 në rreth 11 për qind. Emigrimi, veçanërisht i personave në moshë pune, po ndikon në ofertën e fuqisë punëtore dhe në perspektivën afatgjatë të rritjes. Këto zhvillime pritet të ushtrojnë presion të shtuar edhe mbi sistemet e shëndetësisë, kujdesit afatgjatë dhe mbrojtjes sociale.

Megjithatë, sfida demografike nuk qëndron vetëm te zvogëlimi i popullsisë në moshë pune, por edhe te shfrytëzimi i pamjaftueshëm i potencialit ekzistues njerëzor. Në vitin 2024, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore ishte vetëm 25.9 për qind, krahasuar me 60.6 për qind për burrat. Vlerësimet e Institutit Riinvest trego-

jnë se mbyllja e hendekut gjinor në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore mund të shoqërohet me një rritje potenciale prej 5.9 për qind të PVB-së për kokë banori. Kjo dëshmon se aktivizimi ekonomik i grave dhe grupeve të tjera joaktive përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të zbutur ndikimet e pafavorshme demografike. Megjithatë, përfitimet nuk realizohen automatikisht dhe kërkojnë krijimin e vendeve të punës cilësore, zgjerimin e shërbimeve të kujdesit dhe përmirësimin e politikave të punësimit.

Krahas aktivizimit të fuqisë punëtore, rritja e produktivitetit do të jetë vendimtare për perspektivën ekonomike të vendit. Të dhënat e Institutit Riinvest (2026) dhe vlerësimet rajonale të OECD-së (2026) tregojnë se produktiviteti i punës mbetet ndjeshëm nën mesataren evropiane, ndërsa PVB-ja për banor qëndron në vetëm 29 për qind të nivelit të BE-së. Ky dallim nënvizon rëndësinë e kombinimit të rritjes së produktivitetit me zgjerimin e pjesëmarrjes në tregun e punës. Investimet në arsim, shëndetësi, shkathtësi, teknologji dhe inovacion, së bashku me angazhimin më produktiv të diasporës, përbëjnë parakushte për përshpejtimin e konvergjencës ekonomike.

Në përgjithësi, gjetjet e raportit tregojnë se Kosova duhet të kalojë gradualisht nga një model rritjeje i mbështetur kryesisht në konsum drejt një modeli që mbështetet më shumë në investime produktive, kapital njerëzor dhe produktivitet, siç kemi argumentuar në tre raportet e cikleve të mëparshme të Forumit. Transformimi demografik e bën këtë orientim edhe më urgjent. Në kushtet kur zgjerimi i fuqisë punëtore mund të bëhet gjithnjë e më i kufizuar, rritja e ardhshme ekonomike dhe konvergjenca me BE-në do të varen nga aftësia për të angazhuar më shumë njerëz në aktivitet ekonomik dhe për të krijuar më shumë vlerë të shtuar për çdo të punësuar.

Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, Instituti Riinvest rekomandon sa vijon:

1. **Qeveria, ministritë përkatëse dhe asociacionet e biznesit të mbështesin transformimin strukturor dhe teknologjik të ekonomisë**, përmes nxitjes së investimeve produktive, digjitalizimit, përdorimit të inteligjencës artificiale dhe zhvillimit të aktiviteteve me vlerë më të lartë të shtuar. Prioritet duhet t'i jepet rritjes së produktivitetit, kapaciteteve eksportuese dhe përshtatjes së bizneseve ndaj ndryshimeve teknologjike dhe gjeopolitike.

2. **Ministritë dhe organizatat buxhetore të adresojnë dobësitë kronike në planifikimin dhe realizimin e investimeve publike**, përfshirë projektet e financuara nga huatë ndërkombëtare dhe fondet e BE-së, duke përmirësuar menaxhimin e projekteve, shmangur vonesat dhe zvogëluar shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që cenojnë fondet për investime.

3. **Qeveria të rishqyrtojë prioritetet buxhetore dhe të rrisë gradualisht financimin për arsimin, shëndetësinë, kërkimin shkencor dhe inovacionin**, së paku drejt mesatares së Ballkanit Perëndimor, duke përmirësuar njëkohësisht cilësinë dhe efikasitetin e shpenzimeve. Për kërkimin dhe inovacionin, të shqyrtohet edhe nxitja e financimit privat përmes lehtësirave tatimore, duke përshtatur dhe zgjeruar mekanizmat e paraparë në Ligjin për Sponsorizime.

4. **Institucionet kompetente të adresojnë problemet në sektorin e energjisë elektrike**, përmes përmirësimit të funksionimit të tregut, sigurisë së furnizimit dhe investimeve në kapacitete prodhuese e infrastrukturë, për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe me kosto të përballueshme për familjet dhe bizneset.

5. **Qeveria dhe institucionet përgjegjëse të vlerësojnë efektivitetin dhe ndikimin e skemave të transfereve sociale**, me qëllim sigurimin e një orientimi më të mirë të mbështetjes drejt grupeve më të cenueshme dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike.

6. **Kuvendi, Qeveria dhe institucionet tjera përgjegjëse ta trajtojnë aktivizimin e fuqisë punëtore si prioritet zhvillimor**, me fokus te gratë, të rinjtë dhe personat ekonomikisht joaktivë. Kjo kërkon zgjerimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë dhe të moshuar, përmirësimin e shërbimeve të punësimit dhe aftësimit, si dhe reformimin e politikave të pushimit të lehonisë dhe atij prindëror.

7. **Qeveria të hartojë dhe zbatojë politika aktive demografike për të adresuar rënien e natalitetit, emigrimin dhe plakjen e popullsisë**, duke u mbështetur në masa të targetuara për mbështetjen e familjeve me fëmijë, përmirësimin e qasjes në shërbimet e kujdesit dhe krijimin e kushteve më të favorshme për harmonizimin e jetës familjare me punësimin. Këto politika duhet të përfshijnë edhe masa për mbajtjen dhe kthimin e fuqisë punëtore, angazhimin e diasporës dhe përshtatjen afatgjatë të shërbimeve publike ndaj ndryshimeve demografike

8. **Institucionet përgjegjëse për arsimin dhe zhvillimin ekonomik, në bashkëpunim me sektorin privat, të përmirësojnë shkathtësitë dhe produktivitetin e fuqisë punëtore**, përmes forcimit të arsimit dhe aftësimit profesional, mësimit në vendin e punës, zhvillimit të shkathtësive digjitale dhe mbështetjes së investimeve në teknologji dhe inovacion.

HYRJE

Forumi Ekonomik Vjetor i Institutit Riinvest 2026 (FEV26) sivjet po shënon edicionin e tij të katërt. Forumi po merr karakterin e një ngjarjeje të rëndësishme, duke ofruar një debat të mbështetur në evidencë solide dhe të angazhuar lidhur me ecuritë ekonomike gjatë vitit kalendarik dhe pritjet për vitin vijues. Me një audiencë të përbërë nga aktorët më përgjegjës dhe më të interesuar për zhvillimet ekonomike, me pjesëmarrës të zgjedhur nga institucionet publike, asociacionet e biznesit, udhëheqësit ekzekutivë të bizneseve, ekspertët nga institucionet financiare dhe qarqet kërkimore e akademike, FEV i Institutit Riinvest synon të jetë një ngjarje e shënuar dhe me vizibilitet të lartë për zhvillimet ekonomike në vend. Në përgatitje të FEV26, është hartuar ky raport studimor, i cili përfshin:

a) Dinamikën dhe cilësinë e rritjes ekonomike, politikat ekonomike dhe pritjet për të ardhmen, sidomos për vitin vijues. Raporti jep përgjigje se si rritja ekonomike po sfidohet nga mjedisi global, por edhe më shumë nga konteksti i brendshëm, dhe vlerëson dinamikën e rritjes ekonomike për vitet 2026 dhe 2027.

b) Zhvillimet në mjedisin biznesor dhe intensitetin e barrierave të caktuara me të cilat ballafaqohen bizneset.

c) Një analizë më të detajuar të zhvillimeve demografike dhe ndikimeve të tyre aktuale dhe potenciale në vitet e ardhshme në dinamikën dhe cilësinë e zhvillimit ekonomik e social të vendit, si temë bosht e këtij studimi.

Ky raport është përgatitur në bazë të studimeve të Institutit Riinvest, Programit Qeveritar dhe reflektimit të tij në Draftbuxhetin për vitin 2027, Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, raporteve për shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2026, publikimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës lidhur me ecuritë në sektorë të ndryshëm gjatë vitit 2026, raporteve mujore dhe vjetore të BQK-së, raporteve të fundit të FMN-së, BB-së, BERZH-it dhe BE-së, si dhe parashikimeve të Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw). Veç kësaj, është realizuar një studim në terren me mbi 200 biznese lidhur me perceptimet e tyre për mjedisin biznesor.

Raporti ndërlidhet me aktivitetet e "Forumit 2015", i cili që nga viti 2023 është pjesë e Institutit Riinvest si një program dhe platformë debatesh për integrimin euroatlantik të Kosovës.

Konstatimet e prezantuara në këtë raport përfaqësojnë pikëpamjet e ekipit kërkimor, përkatësisht të Institutit Riinvest, dhe jo domosdoshmërisht të aktorëve të tjerë të përfshirë në realizimin e këtij projekti. Instituti Riinvest falënderon OSF-WB për mbështetjen në realizimin e këtij aktiviteti.

1

RRITJA EKONOMIKE DHE BALLFAQIMET GJEOPOLTIKE DHE TEKNOLOGJIKE

1. RRITJA EKONOMIKE DHE BALLFAQIMET GJEOPOLTIKE DHE TEKNOLOGJIKE

1.1 Zhvillimet në rrafshin global

Në rrafshin global, ekonomia ende po ruan një nivel të caktuar rimëkëmbjeje pas tronditjeve serioze të shkaktuara nga pandemia COVID-19, kriza energjetike dhe çrregullimet në zinxhirët e furnizimit, të ndikuara më tej nga agresioni i Rusisë në Ukrainë dhe lufta në Lindjen e Mesme përgjatë këtij viti. FMN parashikon se rritja ekonomike në vitin 2026 do të jetë më e lartë se në vitin 2025 (3.1% kundrejt 2.5%), dhe, duke supozuar se situata në vatrat e krizës nuk do të përkeqësohet, në vitin 2027 rritja ekonomike globale projektohet të arrijë në 3.4%.

Kjo ecuri i atribuohet masave të politikave ekonomike që kanë shfrytëzuar me efektivitet rezervat dhe instrumentet ekzistuese për përballimin e krizave, si dhe përshtatjes së suksesshme të sektorit privat gjatë përballjes me sfidat serioze të pesë viteve të fundit. Në këtë drejtim kanë kontribuar edhe investimet në sektorët e mbrojtjes dhe në teknologjitë e reja, veçanërisht në inteligjencën artificiale.

Konsiderohet se vendet importuese të energjisë dhe ato me pjesëmarrje të kufizuar në zinxhirët teknologjikë të vlerës janë në një pozitë më të pafavorshme për t'u përballur me pasojat e krizave që kanë vazhduar që nga viti 2020. Në këtë situatë kanë përfituar më shumë vendet me potencial në këta sektorë, si dhe ato që gëzojnë kushte më të favorshme të këmbimit në tregjet ndërkombëtare. Ndërlidhur me këtë, intensifikimi i rritjes së çmimeve të energjisë si pasojë e konflikteve të armatosura në Lindjen e Mesme dhe në Ukrainë ka shtuar presionet inflacioniste. Ky efekt negativ pritet të vazhdojë, në një masë të caktuar, edhe gjatë vitit 2027, me perspektivë të zbutjes së tij në vitet pasuese. Presionet e vazhdueshme inflacioniste mund të kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme të politikës monetare, përfshirë rritjen ose mbajtjen në nivele të larta të normave bazë të interesit. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e kostos së financimit për sektorin privat, duke kufizuar mundësitë për investime dhe zgjerim të aktivitetit ekonomik. Për të njëjtat arsye, mund të shfaqen presione shtesë edhe mbi çmimet e drithërave, veçanërisht si pasojë e luftës në Ukrainë.[1] Këto zhvillime kanë dobësuar fuqinë blerëse, duke prekur veçanërisht kategoritë më të cenueshme të popullsisë. Problemi qëndron në faktin se e gjithë kjo po ndodh në një situatë kur hapësira fiskale dhe rezervat financiare për përballimin e krizave po ngushtohen. Kjo paraqet një rrezik potencial për realizimin e projeksioneve të rritjes ekonomike, në rast se situata në vatrat e krizave dhe konflikteve politike e ushtarake përkeqësohet.

Duke publikuar projeksionet e saj më të reja (Tabela 1), FMN konstaton se rimëkëmbja ekonomike po shoqërohet njëkohësisht me presione fiskale dhe shqetësime për përkeqësimin e kushteve sociale si pasojë e inflacionit. Bazuar në projeksionet e përmendura, pritet që rritja ekonomike globale të përmirësohet në vitin vijues, pas ngadalësimit gjatë këtij viti, ndërsa në SHBA dhe BE pritet të ruhet një nivel i ngjashëm i rritjes ekonomike me atë të vitit të kaluar. Gjermania pritet të tejkaloj një situatë ngecje nga viti 2025 dhe shoqëron trendin e BE-së, gjë që do të përbënte një rrethanë pozitive edhe për Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën. Në ekonomitë në zhvillim dhe tregjet emergjente pritet një përmirësim i rritjes ekonomike krahasuar me vitin e kaluar.

1 Pasiguria për perspektivën ekonomike është shtuar për shkak të inflacionit më të lartë se pritjet, i cili, sipas projeksioneve të FMN-së dhe BB-së (tetor 2026), pritet të arrijë në 4.7 për qind në vitin 2026 dhe 4.1 për qind në vitin 2027.

Paralelisht me kontekstin e prezantuar më lart, mjedisi global i biznesit është përsëri nën presionin e transformimeve të proceseve dhe transaksioneve biznesore, të ndërlidhura me digjitalizimin dhe gjithnjë e më shumë me aplikimin e inteligjencës artificiale (IA). Është e qartë se nuk bëhet fjalë për luhatje të rastësishme, por për transformime të thella në mënyrën e funksionimit, menaxhimit dhe rritjes së bizneseve, që nënkuptojnë një ndryshim rrënjësor të mënyrës se si krijohet vlera e re. Ky lloj disrupcioni, përkatësisht shpërbërje e strukturave të vjetruara biznesore, po e ripërkufizon edhe stabilitetin global dhe konkurrencën në rrafshin global.

Tabela 1. Projeksionet për rritjen globale dhe rajonale ekonomike (%)

	2025	2026	2027
Rritja globale	3.5	3.1 ↓	3.4 ↑
SHBA	2.3	2.3 ↔	2.3 ↔
BE	1.2	1.1 ↓	1.2 ↑
Gjermania	0.2	1.3 ↑	1.1 ↓
Ekonomitë në zhvillim	3.7	4.4 ↑	4.0 ↓

Burimi: FMN, tetor 2026

Megjithatë, ky ndryshim rrënjësor po shoqërohet edhe me shqetësime, madje edhe në mesin e bizneseve globale të konsoliduara, lidhur me shkallën e përgatitjes së tyre për t'u përballur me riorganizimin e imponuar nga këto transformime përmbysëse (disruption). Këto ndryshime po sfidojnë strukturat ekzistuese të biznesit dhe përfshijnë njëkohësisht dimensionin teknologjik, atë ekonomik, si dhe mënyrën e organizimit të punës, kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësive. Këto shqetësime dhe sfida evidentohen edhe në një studim të fundit të McKinsey.[2] Sipas këtij studimi, rreth gjysma e drejtuesve ekzekutivë i vlerësojnë pozitivisht këto ndryshime, ndërsa afro dy të tretat shprehin shqetësime lidhur me aftësinë e bizneseve të tyre për t'u përballur me këto zhvillime, të cilat ushtrojnë presion të vazhdueshëm për rritjen e produktivitetit. Ky transformim teknologjik përmbysës ushtron presion për ndryshimin dhe thjeshtësimin e operacioneve të biznesit përmes përdorimit të IA-së. Megjithatë, nga studimi rezulton se shumica e punëtorëve nuk janë mjaftueshëm të përgatitur për këto ndryshime. Transformimet ekonomike, të ndërlikuara më tej nga zhvillimet gjeopolitike, kërkojnë fleksibilitet më të madh nga bizneset për t'u përballur me ndryshimet dhe për t'u përshtatur me to. Ndërkaq, transformimi i mënyrës së organizimit dhe rrjedhës së punës kërkon thjeshtësimin dhe unifikimin e proceseve brenda organizatës, duke i dhënë përparësi vizionit për inovacion, përcaktimit të qartë të prioriteteve dhe gatishmërisë për të hequr dorë nga aktivitetet apo segmentet jokonkurruese të biznesit. Studimi arrin në përfundimin se bizneset më të suksesshme do të jenë ato që integrojnë IA-në në të gjitha funksionet e tyre dhe investojnë njëkohësisht në teknologji dhe kapital njerëzor, në një raport prej 1:5 në favor të këtij të fundit. Kjo merr rëndësi të veçantë duke pasur parasysh se rreth dy të tretat e njohurive dhe shkathtësive pritet të ndryshojnë brenda një periudhe pesëvjeçare.[3]

1.2 Ballkani Perëndimor (BP)

Pavarësisht kontekstit të përshkruar më lart, Ballkani Perëndimor (BP) ka arritur të rikuperohet nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në vitin 2025, kur norma e rritjes ra nga 3.7% në 2.5%. Gjatë vitit 2026, rritja ekonomike vlerësohet të ketë arritur rreth 3.1%, duke tejkaluar pritjet fillestare, ndërsa për vitin 2027 projektohet një përshpejtim i mëtejshëm në 3.4%. Në këtë përmirësim kanë kontribuar rritja e kërkesës për eksporte, rimëkëmbja e investimeve dhe performanca relativisht e mirë e sektorit të turizmit.[4] Në këtë ecuri po kontribuon edhe Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, zbatimi i të cilit kushtëzohet me përmbushjen e agjendave individuale të reformave nga secili vend përfitues. Ky plan tashmë ka hyrë në gjysmën e dytë të periudhës së zbatimit, ndërsa performanca e vendeve në përmbushjen e reformave dhe shfrytëzimin e fondeve të parapara, prej të cilave dy të tretat janë në formë huash koncesionale dhe një e treta në formë grantesh, ndryshon ndjeshëm. Kosova, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina kanë shënuar vonesa më të theksuara në krahasim me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.[5]

Me një normë të rritjes ekonomike rreth 1.4 pikë përqindjeje më të lartë se mesatarja e BE-së, Ballkani Perëndimor po vazhdon, ndonëse me ritëm të ngadalshëm, procesin e konvergjencës ekonomike drejt niveleve të zhvillimit të BE-së (converge2eu, 2026). Megjithatë, për shkak të ngecjeve në reformat strukturore dhe shfrytëzimit të pamjaftueshëm të potencialit të kapitalit njerëzor, rajoni ende nuk po arrin të realizojë plotësisht potencialin e tij për rritje ekonomike (Banka Botërore, 2026).

2 McKinsey & Company, *The State of Organizations 2026*. Studimi bazohet në intervistimin e drejtuesve të 10,000 bizneseve me të paktën 1,000 të punësuar, në 16 vende të zhvilluara, duke përfshirë 17 industri të ndryshme.

3 Një çështje tjetër që theksohet në studimin e McKinsey është nevoja që secili punëtor të kapërcejë frikën nga IA-i dhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme për ta përdorur atë në punën e përditshme. Në këtë kontekst, një pyetje kyçe për bizneset do të jetë se sa orë në vit investohen në aftësimin e stafit për përdorimin dhe integrimin e IA-së në proceset e punës.

4 BERZH (2026). *Perspektivat Ekonomike Rajonale në Vendet ku Vepron BERZH-i*, shtator 2026

5 Pakoja prej €6 miliardë përbëhet nga nga €2 miliarde grante si mbështeteje buxhetore dhe €4 miliardë në hua koncesionale , 50 për qind të kanalizuar në Infrastrukturë nëpërmjet Western Balkans Investment Framework (WBIF), while the remainder provides direct budget support. (EU Reform and growrth facility)

Tabela 2. Parashikimi i rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor (%)

	Fondi Monetar Ndërkombëtar		Banka Botërore	
	2026	2027	2026	2027
Shqipëria	3.5	3.2 ↓	3.4	3.6 ↑
Bosna e Hercegovina	2.5	2.6 ↑	2.1	2.9 ↑
Kosova	3.5	3.6 ↑	3.6	3.8 ↑
Maqedonia e Veriut	3.5	3.2 ↓	3.2	3.0 ↓
Mali i Zi	3.0	2.8 ↓	3.3	3.0 ↓
Serbia	3.5	3.6 ↑	3.1	3.7 ↑
Ballkani Perëndimor			3.1	3.4 ↑

Burimi: (FMN, tetor 2026 dhe BB tetor 2026)



Me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi, në vendet e tjera të rajonit, normat e rritjes ekonomike, me dallime të caktuara ndërmjet vendeve, pritet të tejkalojnë 3% (Tabela 2). Banka Botërore vë në dukje se rritja ekonomike në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor vazhdon të mbështetet kryesisht në konsumin privat, të nxitur nga rritja e pagave dhe zgjerimi i kreditimit, dhe jo në investime dhe eksporte, të cilat do të siguronin një bazë më të qëndrueshme për rritje ekonomike. Kjo ecuri është shoqëruar me presione të shtuara inflacioniste, ngadalësim të rritjes së punësimit, papunësi të lartë tek të rinjtë dhe, në shkallë të ndryshme ndërmjet vendeve, me një pjesë të konsiderueshme të potencialit të kapitalit njerëzor që mbetet e pashfrytëzuar.[6] Një tjetër karakteristikë e rajonit është ndikimi negativ i rritjes së çmimeve të karburanteve të importuara, presioni mbi konsumin privat dhe zgjerimi i deficiteve të llogarisë rrjedhëse. Një sërë faktorësh ndikojnë negativisht në investime dhe kushtet e financimit, përfshirë rrezikun e perceptuar, krizat institucionale dhe humbjen e ritmit të reformave strukturore. Në ekonomitë ku rritja mbështetet kryesisht në konsumin e nxitur nga rritja e pagave, remitencave, transfereve dhe kreditimit, siç është rasti në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, kjo rritje nuk përkthehet domosdoshmërisht në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe forcimin e potencialit për rritje ekonomike afatgjatë.

Efektet negative të përmendura, sidomos ato që lidhen me rritjen e çmimeve të energjisë, pritet të vazhdojnë, në një masë të caktuar, edhe gjatë vitit 2027, me perspektivë të zbutjes së tyre në vitet pasuese. Presionet e vazhdueshme inflacioniste mund të ndikojnë në mbajtjen e normave të interesit në nivele të larta ose në rritjen e tyre të mëtejshme. Për të njëjtat arsye, mund të shfaqen presione shtesë edhe mbi çmimet e drithërave, veçanërisht si pasojë e luftës në Ukrainë.

Pavarësisht kontekstit të trazuar gjeopolitik dhe presioneve inflacioniste, vlerësimet tregojnë se rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor (BP), ndonëse më e lartë se mesatarja e BE-së, mbetet nën ritmet e shënuara para pandemisë COVID-19. Një sfidë tjetër është se rritja ekonomike në rajon nuk po shoqërohet me një rritje proporcionale të punësimit. Në këto rrethana, perspektiva e rritjes ekonomike është më e favorshme për vendet e Ballkanit Perëndimor që arrijnë të mobilizojnë investime private, publike dhe fonde nga BE-ja. Po ashtu, vendet që zbatojnë politika për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar më, përmirësimin e produktivitetit të punës dhe mbështetjen e kërkimit shkencor dhe inovacionit kanë mundësi më të mëdha për të ruajtur ritmet e rritjes ekonomike, pavarësisht pasigurive dhe sfidave gjeopolitike.

6 Shih edhe Banka Botërore (2026) lidhur me këtë diskutim.

2

ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË KOSOVË

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË KOSOVË

2.1. Dinamika e rritjes ekonomike dhe problemet shoqëruese

Një qeverisje e mirë ekonomike karakterizohet nga një rritje ekonomike e qëndrueshme, nga e cila përfitojnë të gjithë qytetarët. Ajo vlerësohet gjithashtu përmes tri treguesve të tjerë kryesorë: rritjes së punësimit dhe uljes së normës së papunësisë, ruajtjes së një norme të ulët inflacioni dhe një bilanci të qëndrueshëm të pagesave me botën e jashtme (raporte të suksesshme ekonomike ndërkombëtare). Megjithëse Kosova ka ruajtur një ritëm relativisht të qëndrueshëm të rritjes ekonomike, prej 3–4% në vit, kjo performancë nuk ka arritur të zbusë shpërpjesëtimet e trashëguara makroekonomike dhe, rrjedhimisht, as të adresojë në mënyrë të suksesshme sfidat e papunësisë dhe emigrimit, si dhe deficitet e larta tregtare dhe të llogarisë rrjedhëse. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit, vendi është përballur me presione të larta inflacioniste, në disa periudha më të theksuara sesa në vendet e rajonit dhe në BE. [7]

Tabela 3. Parashikimet e rritjes ekonomike në Kosovë (%)

	2026	2027
FMN	3.5	3.6 ↑
Banka Botërore	3.6	3.8 ↑
EBRD	3.5	3.9 ↑
wiiw	4.0	3.8 ↓
MF me draft të Buxhetit 2027	3.8	4.2 ↑
RIINVEST	3.5	3.7 ↑

Burimi: FMN 2026; Banka Botërore 2026; wiiw 2026; Ministria e Financave 2026.

7 Modeli Makroekonomik bazohet në qasjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të njohur si Programimi dhe Politikat Financiare (FPP). Kjo qasje është një kornizë analitike standarde për parashikimet makroekonomike, që lidh sektorin real (PVB-në dhe komponentët e tij), sektorin e jashtëm, atë fiskal dhe monetar në mënyrë që parashikimet të jenë konsistente me njëra-tjetrën. Vlerësimi për vitin 2026 bazohet në skenarin bazik, i cili mbështetet në trendin e variablave pa supozuar ndryshime në politikat sektoriale, i plotësuar me komponentin e kalibrimit. Dallimet potenciale në vlerësimin e konsumit me institucionet tjera ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore, burojnë kryesisht në kohën e publikimit të parashikimeve. Pas mesit të vitit 2026, BQK dhe ASK kanë reviduar të dhënat për vitin 2025, revidim që në terma makro ndikon drejtpërdrejt tek konsumi dhe eksporti neto. Duhet theksuar që revidimi ka ndikuar vetëm në strukturë të PVB-së, pasi që rritja reale ekonomike për vitin 2025 mbetet e njëjtë. Parashikimet e institucioneve ndërkombëtare mund të ketë ndodhë të jenë publikuar para këtij revidimi dhe për rrjedhojë mbështeten në seri të dhënash më të vjetra; modeli i Institutit Riinvest përdor të dhënat e reviduara, si dhe qasjen e kalibruar. Konsumi është ndër sektorët me peshën më të madhe në PVB, prandaj çdo dallim në bazën e të dhënave pasqyrohet në mënyrë të dukshme në vlerësimin e rritjes ekonomike. Komponentët e PVB-së janë deflatuar me deflatorin përkatës, ndaj edhe niveli i çmimeve ndikon në vlerësimin e konsumit. Poashtu, duhet theksuar që dallimet në kontributin individual të komponentëve në rritje janë të papërfillshme kur përdoren të dhënat e pareviduara nga institucionet përkatëse.

Pas ngadalësimit të rritjes ekonomike në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, gjatë vitit 2026 është shënuar një përmirësim, me një rritje reale vjetore të vlerësuar prej 3.5–3.8%. Ky ritëm, sipas parashikimeve, pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027. Parashikimet e FMN-së, BERZH-it dhe wiiw-it, me dallime të caktuara, lëvizin brenda këtij intervali (Tabelat 2 dhe 3). Megjithatë, Kosova pritet të ruajë një dinamikë relativisht më të shpejtë të rritjes ekonomike krahasuar me vendet fqinje, ndërsa Serbia dhe Shqipëria parashikohen të kenë ritme të përafërta të rritjes.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, ASK-ja vlerësoi rritjen reale ekonomike në 5.2% në tremujorin e parë dhe rreth 4% në tremujorin e dytë, krahasuar me periudhat përkatëse të vitit 2025. Këto të dhëna sinjalizonin se rritja ekonomike mund të tejkalonte parashikimet fillestare. Megjithatë, të dhëna të tjera, të bazuara në qarkullimin (shitjet) e deklaruar në ATK për periudhën janar–shtator 2026, sugjerojnë një ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Kështu, vlera e qarkullimit të përgjithshëm, e shprehur në terma realë, është rritur me rreth 3.2%, ndërsa rënie shqetësuese janë regjistruar në sektorin e bujqësisë (7%) dhe të ndërtimtarisë (5%). Zhvillim pozitiv paraqet rritja e qarkullimit në industrinë nxjerrëse (28.9%) dhe industrinë përpunuese (10.26%). Këta sektorë, të cilët së bashku përbëjnë rreth 37% të qarkullimit të përgjithshëm, kanë kontribuar edhe në performancën më të mirë të eksporteve gjatë këtij viti. Prodhimi vendor i energjisë, duke përfshirë të gjitha burimet (termocentralet, hidrocentralet dhe burimet e tjera të ripërtëritshme), është rritur me rreth 4.5%.[8]

Sipas parashikimeve tona, ritmi i rritjes ekonomike pritet të ruhet dhe të përmirësohet lehtësisht gjatë vitit të ardhshëm, nga 3.5% në vitin 2026 në 3.7% në vitin 2027. Ky parashikim mbështetet në supozimin se do të vazhdojë konsolidimi i rritjes së eksporteve, si dhe do të përmirësohet realizimi i investimeve publike dhe shfrytëzimi i fondeve të mundshme nga Plani i Rritjes i BE-së.[9] Këto parashikime janë të përafërta me ato të FMN-së dhe Bankës Botërore, me dallime prej 0.1–0.2 pikë përqindjeje.

Kjo dinamikë e rritjes ekonomike ka qenë dhe mbetet e pamjaftueshme për të nxitur një rritje më të ndjeshme të punësimit dhe uljen e papunësisë. Statistikat e punësimit ende nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar me saktësi krijimin e vendeve të reja të punës dhe dinamikën e punësimit. Bazuar në të dhënat e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, numri i llogarive aktive ka rënë nga 389,828 në qershor 2025 në 356,441 në qershor 2026, që paraqet një zvogëlim prej 33,387 llogarish, apo rreth 8.6%.[10] Nga ana tjetër, sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), numri i punëtorëve të regjistruar në shtator 2026 është rritur krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, nga rreth 414 mijë në 426 mijë, përkatësisht me 12,372 punëtorë, apo rreth 3%.[11] Këto dy burime të dhënash paraqesin tendenca në dukje kontradiktore, të cilat mund të ndërlidhen me dallimet metodologjike, emigrimin dhe formalizimin e punësimit joformal. Megjithatë, ato sugjerojnë se krijimi i vendeve të reja të punës mbetet i pamjaftueshëm. Norma e papunësisë gjatë viteve të fundit ka mbetur rreth 11%, pavarësisht emigrimit të theksuar, duke sugjeruar edhe praninë e problemeve strukturore në tregun e punës.

8 https://ask.rks-gov.net/Themes/Energy

9 Nga gjithsej 882.6 milionë euro të parapara për Kosovën në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së, deri në nëntor 2026 janë disbursuar vetëm 61.8 milionë euro (7%). Gjashtë reforma të parealizuara brenda afatit të qershorit 2026 kanë rezultuar në një humbje të vlerësuar prej 43.8 milionë eurosh, ndërsa 22 reforma të tjera, me vlerë financiare prej 131.5 milionë eurosh, duhet të përmbushen deri në fund të vitit 2026 për të shmangur rrezikun e humbjes së mjeteve përkatëse.

10 Trusti i pensioneve, Buletini për shtator 2025 dhe shtator 2026

11 Të dhënat nga ATK, shtator 2926

Kjo ndërlidhet edhe me nivelin shqetësues të joaktivitetit ekonomik, ku një pjesë shumë e madhe e popullsisë në moshë pune mbetet jashtë tregut të punës, veçanërisht gratë. Krijimi i më shumë vendeve të reja të punës kërkon përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe forcimin e kapaciteteve të ekonomisë për të gjeneruar punësim. Kjo përbën një nga kushtet themelore për uljen e varfërisë dhe zvogëlimin e privimit ekonomik të grupeve të popullsisë që jetojnë nën ose pranë pragut të varfërisë. Këto sfida ndërlidhen ngushtë edhe me tranzicionin demografik, veçanërisht me tendencat shqetësuese të emigrimit dhe rënies së natalitetit. Të gjitha këto çështje, si dhe nevoja për politika aktive demografike, trajtohen më hollësisht në kapitullin 4, i cili i kushtohet temës bosht të këtij raporti: zhvillimeve demografike dhe kapitalit njerëzor. Në këtë kontekst, edhe Banka Botërore (2026) e identifikon shfrytëzimin më të mirë të potencialit të kapitalit njerëzor, veçanërisht përmes rritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës dhe punësimit, si një ndër mundësitë kryesore për përshpejtimin e rritjes ekonomike në Kosovë.[12]

Në sektorin e marrëdhënieve ekonomike me jashtë vazhdojnë të mbeten probleme serioze. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe u shënua një zhvillim pozitiv, me rritjen e eksporteve për 22.4% dhe përmirësimin e shkallës së mbulimit të importeve me eksporte nga 12% në 13.7%. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, si rezultat i lëvizjeve në komponentët e tjerë të bilancit të pagesave, deficiti i llogarisë rrjedhëse u rrit nga 13.5% në 14.6% të PVB-së. Për një analizë më të hollësishme të zhvillimeve në këtë sektor, shihni seksionin 2.3 të raportit.

Shpenzimet qeveritare, përkatësisht shpenzimet buxhetore (shih më hollësisht seksionin 2.5), po karakterizohen nga një ritëm i rritjes nominale pothuajse i përgjysmuar krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa në terma realë mbeten afërsisht në të njëjtin nivel. Një dinamikë e ngjashme pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027. Buxheti mund të japë një kontribut më të madh në rritjen ekonomike nëse përmirësohet ndjeshëm shkalla e realizimit të investimeve kapitale të planifikuara. Përveç kësaj, nevojitet një ristrukturim i prioriteteve buxhetore për të përmirësuar pozitën e arsimit, shëndetësisë, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Sipas projeksioneve buxhetore për vitin 2027, pozita e këtyre sektorëve mbetet kryesisht e pandryshuar dhe dukshëm më e pafavorshme krahasuar me vendet e rajonit.

2.2. Inflacioni dhe shkëndijat e tij nga jashtë e brenda

Sipas të dhënave të fundit nga ASK, 10 nëntor 2026, inflacioni ra në 7,1% në tetor, nga 7,8% në shtator, ndërsa nga muaji në muaj çmimet nuk lëvizën**.** Më së shumti është shtrenjtuar transporti (+21,5%), pasuar nga strehimi dhe energjia (+9,7%), duhani (+5,0%), restorantet (+4,5%) dhe ushqimi (+3,2%). Ky është publikimi i parë sipas COICOP 2018,[13] me bazë 2025=100. Siç shihet nga Figura 1, Kosova mbetet sërish me inflacion mbi dyfishin e Shqipërisë (3,4%) dhe të Maqedonisë së Veriut (3,3%), kurse në shtator ishte mbi çdo vend të BE-së, ku mesatarja ishte 3,8%, me Rumaninë që printe me 6,5%, dhe Suedia me shkallën më të ulët prej 1,0%.

12 World Bank : Western Balkans Regular Economic Report (Tetor 2026)

13 Peshat e produkteve të shportës në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Kosovë tashmë bazohen në të dhënat e llogarive kombëtare sipas COICOP (Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit), të cilat pasqyrojnë më mirë shpenzimet bashkëkohore të familjeve dhe përputhen me standardet statistikore të Bashkimit Evropian. Ky klasifikim i veçon kostot financiare dhe të sigurimeve nga shpenzimet për kujdesin personal, përditëson mënyrën e matjes së shërbimeve dixhitale dhe atyre të ofruara në paketa, si dhe kërkon një përshtatje të kujdesshme kur të dhënat e nën-indekseve pas vitit 2026 krahasohen me trendet historike.

Figura 1. Kosova, Ballkani Perëndimor dhe BE: vendi me inflacionin më të ulët, mesatarja, dhe tre vendet me inflacionin më të lartë.



Burimet: ASK, INSTAT, MAKStat, RZS, MONSTAT, BHAS, Eurostat (2026)
Shtatori është muaji i fundit për të cilin janë publikuar të dhëna për të gjitha vendet; tetori paraqitet vetëm për vendet që kanë publikuar të dhëna (Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut).

Objektivi i inflacionit: 2% (vija e ndërprerë në grafikun origjinal). Vlerat me ngjyrë të kaltër janë të dhëna hyrëse që mund të ndryshohen; grafiku përditësohet automatikisht.

Nafta dhe energjia u shtrenjtuan njësoj për të gjithë rajonin pas luftës në Lindjen e Mesme. Por, te fqinjët i njëjti shok solli inflacion dy-tri herë më të ulët. Kjo nënkupton që shkëndija erdhi nga jashtë, por përshpejtimi u krijua brenda ekonomisë. Kosova importon pothuajse gjithë naftën, një pjesë të konsiderueshme të energjisë elektrike, materialet e ndërtimit dhe pjesën më të madhe të ushqimit, që si i vetëm zë rreth 40% të peshës së shportës konsumuese. Çdo rritje në tregjet botërore po e gjen konsumatorin pa mbrojtje sepse transporti futet në çmimin e çdo malli gjatë zingjirëve të gjatë të furnizimit, dhe me pak importues në sektorët e ekonomisë, rritjet po kalojnë shpejt tek konsumatori e uljet me vonesë. Ndërsa, mungesa e alternativave vendore për produkte po e dëmton vazhdimisht blerësin.

Varësia e madhe ndaj importit shpjegon pse jemi të ekspozuar ndaj goditjeve inflacioniste nga jashtë, por jo pse jemi më keq se të tjerët. P.sh. Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut importojnë po aq dhe me çmime pothuajse të njëjta, e prapë kanë inflacion më të ulët. Kjo tregon se diferencën e bëjnë politikat dhe kërkesa e brendshme. Sipas BQK (2025), inflacioni bazë është 5,1% dhe e shtyjnë shërbimet, që nuk importohen. Gjatë kësaj periudhe, paga minimale u rrit 43% brenda një viti, u miratua paga e 13-të në sektorin publik, remitencat vazhduan, ndërsa produktiviteti ngeli në vend. Çmimet e prodhimit në mars 2026 u rritën me +7,9% dhe paralajmërojnë se kostot vendore ende s'kanë mbërritur plotësisht te konsumatori.

Instrumentet për luftimin e inflacionit Kosova i ka të kufizuara; me euron si valutë monetare pothuajse nuk ka politike monetare (s'mund të përdorë as normat e interesit e as kursin e këmbimit si instrumente rregullimi), siç mundet për shembull Shqipëria, ku forcimi i lekut ka zbutur (me përjashtime) çmimet e importit. Por edhe politika fiskale thuaja si i vetmi instrument në disponim reagoi më dobët në krahasim me rajonin. Për amortizimin e goditjes, Mali i Zi e përgjysmoi akcizën e naftës, Shqipëria e uli automatikisht, ndërsa Serbia dhe Shqipëria ngrinë edhe çmimet. Kosova vendosi vetëm tavan marzhe (12 euro cent/l në pakicë, 2 në shumicë) dhe nuk preku aspak akcizën dhe TVSH-në. Prandaj, transporti u shtrenjtua më shumë se te fqinjët. Energjia elektrike u rrit 16,1% në 2025, efekt që u reflektua në inflacion edhe gjatë 2026 e kësaj i shtohet edhe importi i saj me më shtrenjtë me tërë ndikimin negativ. Kriza politike me zgjedhje të përsëritura, buxhet 'emergjent' të miratuar në shkurt dhe fonde të vonuara të BE-së, e ngadalësoi çdo reagim.

Rritja lineare e pagave publike, paga e 13-të dhe shtesa për përvojë, u proceduan para zgjedhjeve. Ulja e përkohshme e akcizës u refuzua për hir të të hyrave, ndonëse vetë inflacioni i shtoi ato përmes TVSH-së (në TM1 2026 të hyrat u rritën kryesisht falë TVSH-së dhe tatimeve direkte). Fqinjët aktivizuan mekanizmat automatikë për akcizën, që Kosova s'i ka. Edhe po të hiqej marzha, nafta do të lirohej vetëm me disa centë, ndërsa përgjysmimi i akcizës do ta ulte rreth 0,20 euro cent/l, bashkë me TVSH-në që bie me të.

Masat e lartpërmendura mbrojtën të ardhurat nominale të disa grupeve, por nuk e ulën koston e jetesës dhe nuk i targetuan më të cenueshmit. Pensioni bazë u rrit, por të tjerët jo, dhe indeksimi prej vetëm 2,7% mbetet larg inflacionit prej 6–8% dhe kjo po dobëson gjendjen financiare të pensionistëve .

Ligji për Çmime Tavan u miratua sërish në prill 2026, pasi Kushtetuesja e rrëzoi atë të vitit 2023, mirëpo praktika tregon që çmimet tavan sjellin mungesa, cilësi më të dobët, treg informal dhe nuk e prekin koston e importit; andaj kërkojnë mençuri dhe targetim të saktë.

Lëvizjet e tilla tek inflacioni ndikojnë keq tek standardi i pjesës më të madhe të konsumatorëve. Shporta prej 1.000 € e shtatorit 2025 sot kushton rreth 1.078 €, pra 78 € më shumë në muaj dhe afro 940 € në vit (me 7,1% të tetorit, rreth 71 € në muaj). Njëqind euro të kursyera vlejnë sa 92,8 € të vitit të kaluar. Këtë më së shumti po e vuajnë familjet me të ardhura të ulëta, pensionistët, ata me paga të ngrira, d.m.th. ata që shpenzojnë më shumë për ushqim, ngrohje e transport. Po humbin edhe punëtorët informalë, të papunët, bujqit dhe familjet me ndihmë sociale, që s'marrin asnjë mbështetje. Përveç rritjes së çmimeve, në rritje është edhe fenomeni 'shrinkflation', kur blerësi merr më pak mall për të njëjtat para shkaku i zvogëlimit të sasisë së produkteve. Këto praktika e sjellje tregu në rritje kërkojnë vëmendje e adresim institucional.

Inflacioni ka gjasë të ngadalësohet, por do të mbetet mbi rajonin dhe mbi targetin 2%. Kjo s'do të thotë se çmimet bien, por ngadalësohet rritja e tyre. BQK (2026) pret inflacion rreth 4,5% në 2027, ndërsa FMN-ja vlerëson një shkallë prej 3–3,6% për vendet e rajonit, dhe 2% vetëm nga mesi i 2028. Por, dinamikat e Luftës në Lindjen e Mesme, kostot e shtyra të energjisë elektrike për 2027, dimri, pagat, politika fiskale ekspansioniste dhe pasiguria politike mund t'i prishin këto parashikime. Shqetësimi nuk është shpërthimi, por këmbëngulja e inflacionit. Dhe me këto ritme, në fund të 2027 çmimet do të jenë rreth 16% më lart se në fillim të 2025, dhe kjo humbje e fuqisë blerëse të konsumatorit kosovar nuk kthehet vetvetiu.

Në plan afatshkurtër, para dimrit, krahas subvencionit të mirëpritur të rrymës për kategoritë e cenueshme nga qeveria, është e këshillueshme një ulje e përkohshme e akcizës së karburanteve (sot rreth 0,35 €/l), e cila aktivizohet automatikisht mbi një prag të shpallur dhe skadon vetë, si në Mal të Zi e Shqipëri, e cila financohet nga TVSH-ja shtesë që sjell inflacioni. Nga janari 2027 pensionet duhet ta marrin diferencën mes 2,7% dhe inflacionit real, dhe jo me indeksime të disfavorshme. Të krijohet platforma online e krahasimit të çmimeve ditore për produktet e shportës bazë, me të dhëna nga arkat fiskale sepse informacioni rrit vetëdijësimin e konsumatorit dhe minimizon abuzimet. Janë urgjente edhe hetimet për kartele e pozitë dominuese në karburante dhe produkte esenciale si mielli, vaji, sheqeri, qumështi e shitje me shumicë. Monitorimi i publikuar i marzhave në vend të fiksimit të çmimeve, ulja e akcizës kur çmimet kalojnë një prag dhe rritja e rezerva strategjike të naftës e produkteve bazë duhet të kenë prioritet. Ligji i ri për Produktet Bazë poashtu duhet të ketë kritere të matshme dhe afat skadimi që të mos bëhet arbitrar. Autoriteti i Konkurrencës duhet ta ketë prioritet nisjen sa më parë të hetimeve dhe punës serioze në evidentimin e gjendjes në tregje, të analizojë sa ka treg të lirë e konkurrencë fer dhe të rekomandojë politika adekuate në mbrojtje të konsumatorit kosovar dhe të siguroj fair-play në treg për bizneset në përgjithësi.

2.3 Sektori i jashtëm

Kosova hyri në vitin 2026 me një deficit të lartë të tregtisë së mallrave dhe të llogarisë rrjedhëse. FMN-ja (2026) vlerëson se ngritja e çmimeve të energjisë dhe produkteve ushqimore mund ta zgjerojë deficitin e llogarisë rrjedhëse në rreth 10.5% të PVB-së në fund të 2026. Banka Botërore është më pak pesimiste dhe projekton rreth 8.4%. Diferenca ndërmjet projeksioneve tregon pasigurinë e lartë rreth importeve të energjisë, çmimeve ndërkombëtare dhe performancës së shërbimeve. Megjithatë, gjatë viteve të fundit, eksportet e mallrave janë rritur, por jo në masën e nevojshme për të kompensuar zgjerimin e importeve. Nga viti 2019 deri në vitin 2025, importet pothuajse u dyfishuan, nga rreth 3.5 miliardë euro në mbi 7 miliardë euro. Si rezultat, edhe deficiti tregtar u zgjerua ndjeshëm, nga rreth 3.1 miliardë euro në vitin 2019 në 6.1 miliardë euro në vitin 2025.

Gjatë periudhës janar shtator të vitit 2026 vërehet megjithatë një përmirësim relativ në performancën e eksporteve. Eksportet e mallrave arritën në rreth 836 milionë euro, duke u rritur me 22.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Importet, ndërkohë, u rritën me një ritëm më të ngadalshëm, prej rreth 7.9%, duke arritur në 5.65 miliardë euro. Si rezultat, mbulueshmëria e importeve me eksporte u përmirësua nga 13.1% në 14.8%.

Sa i përket strukturës gjeografike të eksporteve, tregjet rajonale vazhdojnë të kenë peshën kryesore. Pothuajse gjysma e eksporteve të mallrave gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2026 u drejtuan në vendet e CEFTA-s, ndërsa rreth një e treta në Bashkimin Evropian. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut përbëjnë së bashku rreth 33.6% të eksporteve totale, ndërsa pesë destinacionet kryesore – Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Gjermania, Zvicra dhe Serbia – përbëjnë rreth 60% të totalit. Afërsia gjeografike dhe lidhjet e krijuara tregtare përbëjnë një avantazh për eksportuesit kosovarë, por përqendrimi i një pjese të madhe të eksporteve në një numër relativisht të kufizuar tregjesh rrit njëkohësisht ekspozimin ndaj ndryshimeve të kërkesës në këto ekonomi.

Tabela 4. Eksporti dhe importi i mallrave 2019-2026

Viti	Eksport	Import	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e eksportit me import (%)
2019	384	3,497	-3,114	11.0%
2020	475	3,297	-2,822	14.4%
2021	756	4,684	-3,928	16.1%
2022	998	5,639	-4,642	17.7%
2023	874	5,913	-5,038	14.8%
2024	944	6,371	-5,428	14.8%
2025	942	7,049	-6,106	13.4%
Janar - Shtator 2025	683	5,232	-4,549	13.1%
Janar – Shtator 2026	836	5,646	-4,810	14.8%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (2026

Gjermania dhe Zvicra kanë rëndësi të veçantë, pasi marrëdhëniet ekonomike me këto dy vende nuk kufizohen vetëm në tregtinë e mallrave. Ato janë gjithashtu ndër burimet kryesore të remitancave dhe investimeve të lidhura me diasporën. Zvicra paraqet një rast veçanërisht të favorshëm edhe në tregtinë e mallrave, pasi gjatë periudhës së analizuar eksportet e Kosovës drejt këtij tregu kanë tejkaluar importet. Në këtë kontekst, fillimi i zbatimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Kosovës dhe EFTA-s gjatë vitit 2026 përbën një zhvillim të rëndësishëm për perspektivën e eksporteve. Marrëveshja krijon kushte më të favorshme për qasje në tregjet e Zvicrës, Norvegjisë, Islandës dhe Lihtenshtajnit[14]. Duke qenë se marrëveshja hyri në fuqi vetëm në pjesën e fundit të vitit (1 tetor 2026), ndikimi i saj në flukset tregtare të këtij viti pritet të jetë i kufizuar, ndërsa efektet potencialisht më të dukshme mund të shfaqen nga viti 2027. Kjo është veçanërisht relevante për Zvicrën, e cila tashmë përbën rreth 9.7% të eksporteve të mallrave të Kosovës.

Struktura e eksporteve sipas produkteve vazhdon të dominohet nga metalet bazë dhe artikujt prej tyre, të cilat përbëjnë rreth 25.5% të eksporteve totale. Pas tyre renditen artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani me 11.7%, plastika, goma dhe artikujt prej tyre me 10.9%, si dhe produktet minerale me 10.6%. Pesha e ushqimeve të përpunuara, plastikës dhe gomës, tekstilit dhe makinerive tregon se baza eksportuese është duke u zëruar ngadalë. Megjithatë, metalet bazë dhe produktet minerale së bashku përbëjnë rreth 36% të eksporteve, duke e bërë performancën eksportuese relativisht të ndjeshme ndaj lëvizjeve të çmimeve ndërkombëtare të mallrave dhe kërkesës

14 https://minti.rks-gov.net/news/nga-1-tetori-hyn-ne-fuqi-marreveshja-e-tregtise-se-lire-kosove-efta-mundesi-te-reja-per-eksportet-kosovare/

industriale. Kjo strukturë e eksporteve merr rëndësi shtesë me hyrjen në fazën definitive të Mekanizmit të BE-së për Rregullimin e Karbonit në Kufij (CBAM) në vitin 2026. Për Kosovën, mekanizmi është veçanërisht relevant për sektorët metalikë dhe produkte të tjera me intensitet të lartë të karbonit. Duke qenë se metalet bazë përbëjnë kategorinë më të madhe të eksporteve të vendit, kërkesat për matjen, raportimin dhe verifikimin e emetimeve mund të ndikojnë gradualisht kostot dhe konkurrueshmërinë e një pjese të prodhuesve eksportues.

Në anën e importeve, Bashkimi Evropian mbetet burimi kryesor importues i Kosovës me rreth 43.8% të importeve totale gjatë periudhës janar–shtator 2026. Gjermania është partneri më i madh individual, me rreth 13.4% të importeve, e ndjekur nga Turqia me 11.6%. Vetëm këto dy vende përbëjnë rreth një të katërtën e importeve totale të Kosovës. Kjo strukturë ndryshon dukshëm nga ajo e eksporteve, ku CEFTA ka peshën më të madhe, duke nxjerrë në pah një asimetri ndërmjet tregjeve ku Kosova eksporton dhe atyre prej të cilave furnizohet.

Struktura e importeve sipas produkteve tregon gjithashtu shkallën e lartë të varësisë së ekonomisë nga furnizimet e jashtme. Produktet minerale përbëjnë kategorinë më të madhe, me rreth 16.2% të importeve. Ngjashëm me vitet paraprake, makineritë, pajisjet dhe veglat elektrike përbëjnë rreth 13% të importeve, ndërsa mjetet e transportit 11.4%. Pesha e këtyre dy kategorive tregon se një pjesë e konsiderueshme e importeve lidhet me mallra kapitale dhe investime, të cilat mund të kontribuojnë në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese.

Shërbimet, në anën tjetër, paraqesin një nga komponentët më pozitivë të sektorit të jashtëm të Kosovës. Ndryshe nga mallrat, ku Kosova vazhdimisht regjistron deficit të konsiderueshëm, tregtia e shërbimeve karakterizohet nga një suficit i lartë dhe në rritje.

Tabela 5. Eksporti dhe importi i shërbimeve 2019-2026

Viti	Eksporti i shërbimeve	Importi i shërbimeve
2019	1,675	749
2020	995	603
2021	2,059	966
2022	2,679	1,282
2023	3,277	1,562
2024	3,736	1,807
2025	4,302	1,932
Janar – Gusht 2025	3,062	1,357
Janar – Gusht 2026	3,351	1,423

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (2026)

Kjo tendencë pozitive ka vazhduar edhe gjatë vitit 2026. Në periudhën janar–gusht, eksportet e shërbimeve arritën në rreth 3.35 miliardë euro, duke u rritur me 9.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Importet e shërbimeve u rritën me një ritëm më të moderuar, prej rreth 4.9%, dhe arritën në 1.42 miliardë euro.

Udhëtimi dominon eksportet e shërbimeve me rreth 72.8% të totalit dhe krijon suficit rreth 1.65 miliardë euro në tetë muaj. Ky fluks lidhet në masë të konsiderueshme me vizitat dhe shpenzimet e diasporës në Kosovë. ICT dhe telekomunikacioni përbëjnë rreth 9.2% të eksporteve të shërbimeve dhe gjenerojnë suficit rreth 252 milionë euro deri ne muajin gusht të 2026. Kjo ndarje është e rëndësishme për perspektivën afatgjatë. Udhëtimi është një burim i madh dhe stabilizues i të ardhurave, por ICT dhe shërbimet e biznesit kanë potencial më të drejtpërdrejtë për rritje të produktivitetit, punësimit të kualifikuar dhe diversifikim të eksporteve. Roli i diasporës nuk kufizohet vetëm te shpenzimet e udhëtimit, por reflektohet qartë edhe te remitancat.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, të hyrat nga diaspora dhe investimet e jashtme direkte (IJD) kanë vazhduar të rriten, por paralelisht është përkeqësuar pozicioni i llogarisë rrjedhëse. Remitencat, arritën në 690.8 milionë euro në gjashtë muajt e parë të këtij viti, nga 650.2 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2025, që përfaqëson një rritje prej rreth 6.2%. Në raport me PVB-në, pesha e remitancave u rrit nga 12.1% në 13.7%. Kjo konfirmon se remitancat vazhdojnë të jenë një nga burimet kryesore të hyrjeve të jashtme dhe një mbështetje e rëndësishme për konsumin e ekonomive familjare.

Tabela 6. Pasqyrë e Bilancit të Pagesave

	Remitancat		**Investimet e jashtme direkte**		**Llogaria rrjedhëse**		**Bilanci nga llogaria financiare**		**Bilanci i pagesave**	
	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)
2019	851.5	12.1	254.6	3.6	-408.3	-5.8	-161.1	-2.3	-399.5	-5.7
2020	980	14.5	345.7	5.1	-454.7	-6.7	-562.1	-8.3	-472.2	-7.0
2021	1153.4	14.5	420.7	5.3	-632.5	-7.9	-365.0	-4.6	-694.7	-8.7
2022	1222.8	13.7	732.0	8.2	-878.7	-9.9	-661.6	-7.4	-917.1	-10.3
2023	1335.8	13.8	840.1	8.7	-729.4	-7.5	-415.5	-4.3	-666.5	-6.9
2024	1355	13.4	793.5	7.8	-914.8	-9.0	-639.3	-6.3	-883.2	-8.7
2025	1,406	12.3	1052.9	9.2	-896.4	-7.9	-626.8	-5.5	-860.6	-7.5
2025 (Janar - Qershor)	650.2	12.1	436.6	8.1	-745.5	-13.8	-604.6	-11.2	-730.4	-13.5
2026 (Janar - Qershor)	690.8	13.7	517.9	10.3	-821.3	-16.3	-617.5	-12.2	-737.2	-14.6

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rritje edhe më e lartë është regjistruar te investimet e jashtme direkte. Gjatë periudhës janar–qershor 2026 pesha e tyre ndaj PVB-së u rrit nga 8.1% në 10.3%. Megjithatë, rritja e vlerës së IJD-ve ende karakterizohet me strukturën e pavolitshme sektoriale, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre vazhdon të jetë e orientuar sektorëve jo të tregtueshëm, duke kufizuar ndikimin e drejtpërdrejtë në kapacitetet prodhuese dhe eksportuese. Nga rreth 692.9 milionë euro IJD të regjistruara deri në gusht 2026, rreth 460 milionë euro, apo 66.4% e totalit, janë orientuar në aktivitetet e patundshmërisë, kryesisht nga diaspora. Krahas kësaj, investimet në prodhim mbeten relativisht të kufizuara. Deri në gusht 2026, prodhimi tërhoqi rreth 35 milionë euro, apo vetëm 5% të IJD-ve totale, ndërsa tregtia me shumicë dhe pakicë rreth 24.5 milionë euro, ose 3.5%. Sa i përket origjinës, Gjermania është burimi më i madh i IJD-ve, me rreth 172 milionë euro, apo 24.8% të totalit, e ndjekur nga Zvicra me 120.5 milionë euro (17.4%). Turqia përbën rreth 12.2% të IJD-ve, me 84.7 milionë euro, ndërsa Shtetet e Bashkuara rreth 7.9%, me 54.6 milionë euro. Së bashku, këto katër vende përbëjnë mbi 62% të hyrjeve të IJD-ve gjatë periudhës janar – gusht 2026.

Edhe struktura e remitancave sipas vendeve të origjinës konfirmon varësinë e lartë të Kosovës nga disa qendra kryesore të diasporës. Gjermania mbetet burimi dominues i remitancave, me rreth 309.8 milionë euro deri në muajin gusht të 2026, ndërsa Zvicra renditet e dyta me rreth 136.4 milionë euro. Pas tyre renditen Shtetet e Bashkuara, Austria dhe Suedia.

Pavarësisht rritjes së remitancave dhe IJD-ve, deficiti i llogarisë rrjedhëse është zgjeruar. Në gjysmën e parë të vitit 2026 ai arriti në 821.3 milionë euro, krahasuar me 745.5 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2025, që paraqet një përkeqësim prej rreth 10.2%. Në raport me PVB-në, deficiti u thellua nga 13.8% në 16.3%. Ky zhvillim reflekton faktin se rritja e hyrjeve nga remitancat, shërbimet dhe investimet nuk ka qenë e mjaftueshme për të kompensuar plotësisht deficitin e lartë të tregtisë së mallrave dhe kërkesën e vazhdueshme për importe.

2.4 Sektori financiar

Sektori financiar në Kosovë vazhdon trendin pozitiv të rritjes, performancës dhe stabilitetit. Në strukturën e bankave komerciale operojnë gjithsej 10 banka, prej të cilave 7 janë me pronësi të huaj, dhe përbëjnë 82.2% të aseteve totale. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, numri i njësive mbetet i pandryshuar, mirëpo numri i të punësuarve ka shënuar ulje të lehtë.

Sa i përket treguesve financiarë për profitabilitet dhe kapitilizim, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, ROA ka zbritur nga 2.5% në 2.2%, ndërsa ROE ka zbritur nga 18.4% në 16.9%. Kjo rënie sugjeron se rritja e fitimit neto ka qenë më e ngadaltë krahasuar me rritjen e aktiveve dhe kapitalit të sektorit bankar. Rritja e shpenzimeve operative të bankave komerciale është një ndër faktorët ndikues në uljen e profitabilitetit. Megjithatë kësaj rënie të lehtë, bankat në Kosovë vazhdojnë të kenë kthim të lartë mbi kapitalin e investuar, duke i bërë ato tërheqëse për investitorë.

Raporti kredi/depozitë gjatë periudhës Janar-Shtator 2026 ka arritur në 87.7%, duke shënuar ulje prej një pike përqindje krahasuar me vitin paraprak. Nëse analizojmë këtë indikator përgjatë periudhës 2019-2026, shohim se kreditë janë zgjeruar më shumë krahasuar me depozitat. Në anën tjetër, raporti i likuiditetit ka shënuar rritje krahasuar me dy vitet paraprake, duke arritur 31.8% gjatë periudhës Janar-Shtator 2026. Kjo shifër dëshmon se bankat kanë kapacitet të mjaftueshëm të mbulojnë detyrimet e tyre afatshkurtëra. Kreditë jo performuese poashtu vazhdojnë të mbesin në nivel të ulët (2%).

Figura 2. Indikatorët e likuiditetit dhe raporti kredi/depozitë për bankat komerciale, periudha 2019-2026



Burimi: BQK (2026)

Kreditimi në sektorët e ekonomisë ka shënuar rritje prej 12.9% gjatë periudhës Janar-Shtator 2026, një ulje prej 6.6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2025. Rritjen më të lartë të kredive vazhdojnë ta shënojnë ekonomitë familjare me 16.9%, pasuar nga kreditë e korporatave jo-financiare me 9.9%. Mirëpo, edhe këto dy kategori kanë shënuar ulje në normën e rritjes së kredive karahasuar me dy vitet paraprake. Kjo ulje vie si pasojë e dobësimit të kërkesës për kredi. Ekonomitë familjare ulën kërkesat e tyre për kredi personale/konsumatore, ndërsa korporatat e mëdha ulën kërkesat e tyre për kredi për financim të inventarit/kapitalit punues dhe investimeve fikse gjatë tremujorit të parë të vitit 2026.

Për dallim nga tremujori i parë, sipas të dhënave të Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë për tremujorin e dytë të vitit 2026, rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet është mbështetur kryesisht nga financimi i investimeve fikse, inventari dhe kapitali punues. Këto të gjetura tregojnë se kredimarrja gjatë kësaj periudhe nuk është nxitur vetëm nga nevojat afatshkurtëra të likuiditetit, por edhe nga zgjerimi i aktivitetit ekonomik dhe investimet në asete afatgjata.

Sa i përket strukturës së kredive sipas sektorëve, nuk shohim ndryshim me vitet e mëparshme. Shërbimet vazhdojnë të dominojnë portfolin e kredive me 64.4%, pasuar nga industria, energjia dhe ndërtimi me 33.9%. Ndërsa, kreditë bujqësore përbëjnë më pak se 2% të portofolit total.

Figura 3. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave gjatë periudhës 2020-2026 (në %)



Burimi: BQK (2026)

Paralelisht, depozitat janë rritur në 14.15%, duke shënuar rritjen më të lartë gjatë periudhës analizuese 2020-2026. Rritja e depozitave u mbështet nga rritja e kursimeve të familjeve dhe bizneseve, por edhe nga zgjerimi i preferencës për të mbajtur më shumë fonde si pasojë e pasigurisë ekonomike. Poashtu, meqenëse kërkesat për kredi janë ngadalësuar, kjo ka rritur numrin e fondeve të mbetura në llogaritë bankare.

Normat e interesit janë rritur karahasuar me vitet paraprake (shih Figurën 3). Përgjatë periudhës Janar-Shtator 2026, norma mesatare e interesit në kredi ka arritur 6.9%, duke shënuar normën më të lartë përgjatë periudhës krahasuese. Poashtu, norma e interesit në depozita është rritur në 3.2%, duke shënuar rritje më se të dyfishuar krahasuar me vitin 2019. Këto shifra përkrahin të gjeturat e mësipërme, dhe arsyetojnë pse ekonomitë familjare dhe korporatat e mëdha kanë ulur kërkesat e tyre për kredi, dhe kanë rritur depozitat në banka.

Figura 4. Normat e interesit të kredive dhe depozitave, periudha 2019-2026 (në %)



Burimi: BQK (2026)

Përpos bankave komerciale, treguesit për profitabilitet dhe kapitalizim shënuan trend rënës edhe për kompanitë e sigurimeve. Përgjatë muajit Shtator 2026, ROA qëndroi në 4.4%, rënie prej 2.3 pikë përqindje krahasuar me muajin Shtator 2025. Gjatë të njëjtës periudhë, ROE ishte 14.1%, duke shënuar ulje prej 7.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Poashtu edhe fitimi neto i kompanive të sigurimit ka shënuar ulje prej 2.3 pikë përqindje. Këto të dhëna tregojnë se profitabiliteti i kompanive të sigurimit është dobësuar në vitin 2026 si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative, rënies së të ardhurave nga primet, apo kosto më të larta nga dëmet e paguara.

Ndryshime të dukshme kanë pësuar edhe institucionet mikrofinanciare. Rritja vjetore e kredive në Shtator të vitit 2026 ishte 6.1%, rreth 14.7 pikë përqindje më pak se në vitin paraprak. Poashtu, rënie të dukshme shënoi edhe rritja e kredive për ekonomi familjare, e cila ishtë 9.8% në vitin 2026, 11.4 pikë përqindje më e ulët se vitin paraprak. Rënia e kërkesës për huamarrje, kostot më të larta të financimit, dhe pasiguritë ekonomike janë disa prej faktorëve që ndikuan në këtë trend rënës.

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të lartë ndaj sektorit të jashtëm. Fondi i Kursimeve Pensionale kryeson me 3.5 miliardë euro në asete të jashtme neto, pasuar nga 1.6 miliardë euro të BQK-së, dhe 1.1 miliardë euro të bankave komerciale. Kjo varshmëri paraqet sfidë për asetet pensionale dhe të bankave komerciale, meqenëse luhatjet në tregje ndërkombëtare ndikojnë dukshëm në luhatjet e brendshme.

Sa i përket performancës së fondeve pensionale, vlera e aksionit për FKPK është rritur nga 1.94 eur në 2.17 eur, si dhe vlera e aksionit të FSKP, është rritur nga 222.8 eur në 247 eur. Mirëpo, gjatë këtij viti tregjet financiare nuk kanë qenë aspak të favorshme, sepse shohim ulje të konsiderueshme në kthimin në investime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kthimi në aksione për FSKP ka zbritur për 57.6%, ndërsa për FKPK ka zbritur për 37.6%. Poashtu shohim ulje në numrin e kontribuesve të ri, si dhe në vlerën e aseteve. Vlera e aseteve te FKPK ka shënuar ulje të konsiderueshme prej 17.4%, ndërsa edhe numri i kontribuesve të rinjë ka rënë për 15%.

Figura 5. Indikatorët e performancës së Fondeve Pensionale, analizë krahasuese Shtator 2025/2026, (në %)



Burimi: BQK (2025)

2.5 Shpenzimet qeveritare

Projekti i buxhetit të Kosovës për vitin 2027 vazhdon me një orientim të ngjashëm me vitet e kaluara me pikësynim të ruajtjes së stabilitetit fiskal por jo edhe kontributin e domodoshëm të politikës fiskale **për mbështetjen e faktorëve** të rritjes ekonomike cilësore dhe të qëndrueshme. Kjo ka të bëjë me pozitën jo adekuate në strukturën e destinimeve buxhetore për arsimin, shëndetësinë, kërkimet dhe inovacionet si dhe me dobësitë kronike në realizmin e investimeve të parapara publike nga buxheti.

Buxheti për vitin e ardhshëm parasheh rritje nominale të shpenzimeve, por ulje të peshës së tyre në PVB. Shpenzimet janë planifikuar të arrijnë në 4.27 miliardë euro, ose 4,9% më shumë se në buxhetin e rishikuar për vitin 2026, por që është më e ulët se norma e rritjes së vitit të kaluar prej 9%. Meqë PVB-ja nominale parashikohet të rritet më shpejt se shpenzimet, pesha e tyre bie nga 33 % në 32 % të PVB-së. Nga ana tjetër, të ardhurat buxhetore janë planifikuar në 4.00 miliardë euro ose 6,7% më shumë se vitin e kaluar por që është m**ë e ulët se norma e vitit të kaluar prej 9 %. Kësi soji** deficiti i përgjithshëm pritet të ulet nga 321 në 266 milionë euro, përkatësisht nga 2,7% në 2,0% të PVB-së. Nga e tërë kjo del se është evident një ngadalësim i rritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve **për vitin 2026 ashtu edhe për vitin 2027.**

Rishikimi i buxhetit për vitin 2026 rezultoi me ndryshime në strukturën tij në raport me buxhetin fillestar, rishikimi shtoi 102 milionë euro për paga dhe shtesa dhe 20 milionë euro për subvencione dhe transfere.

Në anën e të ardhurave një pjesë e rritjes së parashikuar erdhi nga dividendët (KEK dhe Telekom) dhe grantet për mbështetje buxhetore. Ky dallim ka rëndësi për qëndrueshmërinë fiskale. Dividendët dhe grantet mund ta lehtësojnë financimin në vitin kur arkëtohen, ndërsa masat që rrisin pagat ose përfitimet në mënyrë të përhershme kërkojnë burime të qëndrueshme edhe në vitet ardhshme. Prandaj, për ta vlerësuar qëndrueshmërinë e buxhetit, duhet parë nëse rritja e të ardhurave rrjedhëse të përsëritshme e mbulon koston e zotimeve që vazhdojnë përtej një viti buxhetor.

Edhe institucionet ndërkombëtare e vlerësojnë disiplinën fiskale si një rrethanë pozitive por shprehin një brengë për zgjerimin e bazës së shpenzimeve dhe presionet e obligimeve të shtuara fiskale për qëndrueshmërinë afatmesme.[15] Ky zgjerim fiskal ka mbështetur të ardhurat familjare dhe aktivitetin ekonomik në afat të shkurtër, por kërkon kujdes se për shkak të detyrimeve të vazhdueshme buxhetore që krijohen në afatgjatë[16]. FMN-ja rekomandon një politikë fiskale më të kujdesshme si një masë për të parandaluar presionet inflacioniste, ajo rekomandonte një deficit rreth 1% të PVB-së, kundrejt nivelit prej rreth 2% në skenarin e planifikuar bazë.

Këto zhvillime sugjerojnë se qëndrueshmëria dhe ndikimi zhvillimor i buxhetit varen nga aftësia për të siguruar të ardhura të qëndrueshme, për të kontrolluar zotimet e përhershme dhe për t'i orientuar burimet drejt investimeve që rrisin produktivitetin, kapitalin njerëzor dhe kapacitetet prodhuese.

15 Banka Botërore Banka Botërore posaçërisht e evidenton faktin se gjatë shtatë muajve të vitit 2026, të hyrat u rritën me 9% në bazë vjetore, ndërsa shpenzimet me 19%.

16 Banka botërore (2026), *western balkans regular economic report no. 30: from market entry to export endurance*,

Tabela 7. Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore (miliarda euro)

	2024 (Realizuar)	2025 (Realizuar)	2026 (Rishikuar)	2027 Parashikim	2027/2026 %
Të ardhurat buxhetore	3.088	3.343	3.749	4.002	+6.7 %
Shpenzimet buxhetore	3.123	3.427	4.071 M	4.269	+4.9 %
Bilanci buxhetor	-35 milion	-84 milion	-321 milion	-267 milion	
Bilanci buxhetore si % e PVB	-0.3%	-0.8%	-2.7%	-2.0%	
Shpenzimet buxhetore si % e PVB	30.2%	31.1%	33.6%	31.9%	

Burimi: Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027

Të ardhurat buxhetore

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, të ardhurat buxhetore, përfshirë grantet arritën në 2.65 miliardë euro ose rreth 70% të planifikimit vjetor të rishikuar. Brenda tyre, tatimet direkte u rritën me 15 %, në 490 milionë euro, ndërsa tatimet indirekte u rritën me 7,3%, në 1.97 miliardë euro. Megjithëse tatimet direkte u rritën më shpejt, tatimet indirekte dhanë kontribut më të madh në euro për shkak të bazës së tyre më të gjerë. Rritja prej 8% e vlerës së importeve, krahas rënies prej 0,6% të vëllimit të importit të rregullt të mallrave, sugjeron se çmimet më të larta dhe ndryshimet në përbërjen e importeve mund të kenë mbështetur një pjesë të rritjes së të ardhurave në kufi. Sa i përket politikës së mbledhjes së TVSH-së edhe këtë vit ajo mbetet pothuajse e njëjtë me ritmet e viteve të kaluara ku rreth 32% mblidhet brenda vendin dhe rreth 64% në kufi. Mbledhja e TVSH-së në kufi është një barrë të konsiderueshme për bizneset të cilat në pjesën më madhe detyrohen ti paguajnë ende pa filluar shitjet e produkteve e cila e ul aftësinë konkurruese dhe likuiditetin e tyre.

Për vitin 2027, me projektbuxheti parashihen 4,00 miliardë euro të ardhura, ose rreth 253 milionë euro më shumë se viti 2026. Pothuajse e gjithë rritja neto mbështetet te tatimet indirekte, të cilat parashikohen të shtohen me rreth 251 milionë euro. Rritja prej rreth 44 milionë euro e tatimeve direkte dhe rimbursimet më të ulëta tatimore kompensojnë rënien e parashikuar të të ardhurave jotatimore dhe të granteve. Vetëm TVSH-ja në kufi pritet të sigurojë rreth 1.29 miliardë euro, ose 32% të të hyrave të përgjithshme. Akciza pritet të sigurojnë 756 milionë dhe detyrimet doganore 218 milionë euro. Këto projeksione konfirmojnë vazhdimësinë e një strukture të mbështetur kryesisht në tatimin e konsumit dhe importeve. Nëse këto rriten më ngadalë se sa parashikohet, të ardhurat mund të ulen dhe deficiti të jetë më i lartë, nëse shpenzimet realizohen sipas planit.

Për qëndrueshmërinë fiskale ka rëndësi se nga vjen rritja e të ardhurave. Rritja e të ardhurave nga mbi bazë të rritjes së çmimeve mund ta përmirësojë përkohësisht bilancin nominal, ndërsa formalizimi i bizneseve dhe i punësimit mund ta zgjerojë bazën tatimore edhe për vitet pasuese. Kur të ardhurat shtesë te njëkohshme përdoren për të financuar paga ose transfere krijojnë detyrime të përhershme përmbushja e të cilave mund te sfidohet. Për këtë arsye, zgjerimi i bazës tatimore dhe përmirësimi i përmbushjes së detyrimeve tatimore do ta bënin financimin e këtyre zotimeve më pak të varur nga luhatjet e konsumit, importeve dhe çmimeve.

Tabela 8. Struktura e të hyrave buxhetore (miliona euro)

	2024 (Realizuar)	2025 (Realizuar)	2026 (Rishikuar)	2027 (Parashikim)
Tatimet Direkte	534,5	559,2	675,5	719,1
Tatimet Indirekte	2.249,8	2.490,3	2.724,6	2.975,3
Të Hyrat Jo-Tatimore	292,9	339,5	399,7	378,0
Grantet dhe ndihmat	30,0	22,5	52,5	22,5
Totali i të ardhurat buxhetore	3.028	3.426,3	3.749.3	4,002.2

Burimi: Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027; kalkulimet e autorit nga seritë fiskale

Shpenzimet buxhetore

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, shpenzimet buxhetore, arritën në 2.59 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 14,9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo përfaqëson rreth 63 % të shpenzimeve të planifikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2026. Zgjerimi u përqendrua kryesisht në shpenzimet rrjedhëse; pagat dhe shtesat u rritën me 16 %, ndërsa subvencionet dhe transferet me 26,8%. Këto zhvillime lidhen me pagesën e pagës së trembëdhjetë dhe zgjerimin e mbështetjes financiare për skemat sociale. Në drejtim të kundërt , shpenzimet kapitale u zvogëluan për 3,2%[17].

Për vitin 2027, shpenzimet rrjedhëse pritet të arrijnë në 3.13 miliardë euro ose rreth 73,4% të totalit të buxhetit. Nga këto shpenzime, subvencionet dhe transferet mbeten kategoria më e madhe me 1,45 miliardë euro, të pasuara nga pagat dhe shtesat me 1.08 miliardë euro, së bashku, këto dy kategori përbëjnë rreth 59,3% të shpenzimeve të përgjithshme. Krahasuar me planifikimin e rishikuar për vitin 2026, subvencionet dhe transferet rriten me rreth 4,9%, mallrat dhe shërbimet me 7,9%, ndërsa pagat dhe shtesat mbeten pothuajse në të njëjtin nivel. Investimet kapitale janë planifikuar në 1.07 miliardë euro me pjesëmarrje prej 25,1% në shpenzimet totale. Megjithatë, rënia e realizimit të tyre gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2026 nënvizon se ndikimi i këtyre ndarjeve do të varet nga përmirësimi i përgatitjes dhe zbatimit të projekteve për të cilat janë destinuar.

Struktura e shpenzimeve buxhetore përcakton edhe mënyrën se si buxheti ndikon në ekonomi. Pagat dhe transferet mund të mbështesin konsumin në afat të shkurtër por efekti mbi prodhimin vendor varet nga ajo se sa prej të ardhurave shtesë familjet i shpenzojnë dhe sa prej kërkesës plotësohet me mallra e shërbime vendore. FMN-ja vlerësonte se mbi 80% e rritjes së projektuar të shpenzimeve për periudhën 2024–2026 buronte nga shpenzimet rrjedhëse dhe rekomandonte mbështetje sociale më të targetuar dhe menaxhim më të mirë të investimeve publike. Për buxhetin e vitit 2027, kjo e zhvendos vëmendjen te dy çështje konkrete. Sa mirë arrijnë transferet te familjet që kanë nevojë për mbështetje dhe sa prej projekteve të buxhetuara mund të përfundojnë e të ofrojnë përfitimet e pritshme?

17 Ministria e Financave: Korniza Makro Fiskale, Drafti i Buxhetit 2027

Tabela 9. Struktura e shpenzimeve buxhetore

	2024 (Realizuar)	2025 (Realizuar)	2026 (Rishikuar)	2027 (Parashikim)	2027/2026 %	2027/2024 %
Paga dhe shtesa	805.4	910.6	1082.4	1084.9	+0.2%	**+34.7%**
Subvencione dhe Transfere	1062.3	1232.5	1378.1	1445.9	+4.9%	**+36.1%**
Shpenzimet Kapitale	859.2	720.1	998.4	1070.5	+7.2%	**+24.6%**
Mallra dhe Shërbime	519.0	470.3	545.4	588.6	+7.9%	**+13.4%**
Interesi për Borxhin Publik	43.2	51.0	44.5	55.0	+23.6%	**+27.3%**
Totali i shpenzimeve buxhetore në milionë	3,123.9	3,426	4,070.8	4,268.7	+9.9%	**+28.8%**

Burimi: Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027

Realizimi i investimeve kapitale

Realizimi i ulët i investimeve kapitale vazhdon me vite të mbetet një nga problemet kyçe lidhur me realizimin e politikës fiskale të Kosovës. Me gjithë një përmirësimi të përqindjes vjetore të realizimit në vitin 2025 megjithatë një pjesë e konsiderueshme e ndarjeve ka mbetur e pashpenzuar çdo vit. Deri në fund të shtatorit 2026 janë realizuar vetëm 37% të shpenzimeve kapitale ose 376 milionë euro krahasuar me 42 % në periudhën e njëjte të vitit të kaluar. Deri në dhjetor mbeten edhe diku 639.5 milionë euro për t'u shpenzuar [18]. Ndërkohë, raporti mbi realizimin e buxhetit evidenton realizim prej 80% për pagat dhe 76% për subvencionet dhe transferet, duke treguar dallim të theksuar ndërmjet ekzekutimit të shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre kapitale, zhvillime këto të ndikuara edhe nga ciklet e shpeshta elektorale.

Raporti nëntëmujor për realizmin e buxhetit të sivjetmë evidenton edhe një problem kur është fjala tek realizimi i shpenzimeve të raportuara si kapitale. Brenda kësaj kategorie 82,1 milionë euro janë regjistruar si pagesa për zbatimin e vendimeve gjyqësore, krahasuar me 56,81 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2025. Këto pagesa përbëjnë rreth 21,8% të shpenzimeve kapitale të raportuara që është një tregues mjaft shqetësues për cilësinë e menaxhimit të projekteve publike nga buxheti. Pa këto pagesa shpenzimet kapitale arrijnë vetëm 294,74 milionë euro, më pak se 1/3 e atyre të planifikuara . Raporti i auditimit të vitit 2025 nuk jep një përgjigje të saktë se për çka janë shpenzuar këto para, por i evidenton vetëm si *"klasifikim i shpenzimeve jo adekuate"*. Për vitin 2025, institucionet që kanë shpenzuar më së shumti para si klasifikim jo adekuat janë; Ministria e Brendshme (10 milion), SHSKUK (2.5 milion), MMPHI (2.6 milion) ndërsa në nivel lokal; Komuna e Ferizajit (4.5 milion), Komuna e Prishtinës (3.2 milion) dhe Komuna e Podujevës (2.6 milion).

18 Ministria e Financave (2026) Raporti Nëntëmujor Financiar.

Gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025 theksojnë gjithashtu ngecjen në shfrytëzimin e huave të jashtme për shkak të problemeve në menaxhimin e projekteve infrastrukturore dhe shpronësimet gjatë planifikimit ose zbatimit. FMN-ja gjithashtu paralajmëron se përdorimi i fondeve të investimeve për detyrime gjyqësore dhe klasifikimi i pasaktë i shpenzimeve shtrembërojnë të dhënat mbi realizimin e investimeve publike. Kjo performancë brengosëse në realizimine projekteve nënkupton shtyrjen e përfitimeve të pritshme nga infrastruktura, shërbimet publike dhe përmirësimi i kushteve për bizneset. Ndarjet buxhetore kanë ndikim të kufizuar zhvillimor kur projektet nuk realizohen në kohë ose kur mjetet përdoren për detyrime që nuk krijojnë kapital të ri. Përqendrimi i një pjese të madhe të pagesave në fund të vitit mund të shtojë presionin mbi mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë. Për këtë arsye, rritja e buxhetit për investime kapitale për vitin 2027 duhet të shoqërohet me projekte të përgatitura paraprakisht, zgjidhjen në kohë të çështjeve pronësore, kalendar realist të prokurimit dhe monitorim të progresit fizik krahas pagesave financiare. Përmirësimi i realizimit duhet të matet edhe me cilësinë dhe funksionalitetin e investimeve të përfunduara.

Tabela 10. Buxhetimi dhe realizimi i investimeve kapitale (milion euro)

	2022	2023	2024	2025	2025 (Janar – Shtator)	2026 (Janar – Shtator)
Buxhetimi i Investimeve kapitale	704.0	819.9	859.2	930.3	930.3	1016.3
Realizimi i Investimeve kapitale	419.2	554.4	654.6	729.4	388.66	376.8
Investimet e pa realizuara	284.8	265.5	204.6	200.9	541.66	643.3
Përqindja e realizimit	60%	68%	76%	78%	42%	37%

Burimi: Projekt ligjet për ndarjet buxhetore: 2022 – 2027, dhe seritë kohore fiskale të kalkuluara nga autori

Shëndetësia, arsimi, kërkimet dhe inovacionet

Arsimi dhe shëndetësia si dy sektorët që kërkojnë rritje të financimit publik dhe orientim më të mirë të mjeteve drejt nevojave më urgjente. Sipas ndarjeve buxhetore për vitin 2027 parashikohen 414 milionë euro për arsimin dhe 418 milionë euro për shëndetësinë, ose rreth 3,1% e PVB-së për secilin sektor, tregues ky i cili sugjeron një përkeqësim të pozitës së këtyre sektorëve. Krahasuar me ndarjet e vitit 2026 financimi i arsimit rritet me 3,5% në terma nominalë, që do të thotë më ngadalë se shpenzimet e përgjithshme buxhetore, të cilat rriten me 4,9%. Në shëndetësi, financimi rritet me 7,5%, por rreth 90% e shtesës neto shkon te SHSKUK-ja, ndërsa granti komunal për shëndetësi bie nga 86,92 në 85,86 milionë euro. Me financim publik të ulët në raport me rajonin dhe me pagesa nga xhepi që, sipas Bankës Botërore, përbëjnë rreth 38–40% të shpenzimeve totale shëndetësore. Përmirësimi i gjendjes në këta sektorë është një domosdo në mënyrë që rritja ekonomike të përfitojnë sa më shumë qytetarë e sidomos ata që janë nën pragun e varfërisë ose afër tij. Kjo është në fakt formë më efikase e përkujdesjes sociale dhe për reduktimin e varfërisë.

Në gjendje edhe më të palakmueshme është financimi i kërkimeve dhe inovacioneve nga fondet publike. Kjo madje është e pamundur të identifikohet në strukturën e destinimeve buxhetore. Ligji mbi Shkencën përcakton një obligim që 0.7% e buxhetit të caktohet për mbështetjen e kërkimeve shkencore . Deri tani nuk është realizuar as 1/3 e këtij përcaktimi. Derisa vendet e rajonit në mesatare mbështetja e kërkimeve shkencore arrin në mesatare rreth 0.5% të PVB e në BE kjo është rreth 2%, të ne kjo është rreth 0.1%. Kjo gjendje është kështu me dekada, por tani siç u tha bënë me dije ndryshimet radikalë teknologjike, gjeopolitike dhe të proceseve të punës e shtojnë presionin për rritje të produktivitetit dhe inovacioneve për të përmirësuar aftësitë konkurruese, proces nga i cili varet perspektiva jonë lidhur me dinamikën, strukturën dhe cilësinë e zhvillimit ekonomik. Kjo e bën edhe urgjente që për këta sektorë Qeveria dhe aktoret interesuar të marrin masa për të caktuar një program të përqendruar në ndryshimin efektive të gjendjes me ngritje të nivelit të financimit dhe shfrytëzimin e tyre efektive për të përshpejtuar dhe ngritur cilësinë e rritjes ekonomike në vendin tonë.

Tabela 11. Buxheti për shëndetësi dhe Arsim (milion)

	2025	2026	2027	2027/2026
Buxheti për Shëndetësi	**369.64**	**389.34**	**418.43**	**+7.47%**
Ministria e Shëndetësisë	82.42	99.85	101.10	+1.25%
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar (SHSKUK)	190.66	190.95	217.10	+13.69%
Fondi I sigurimeve shëndetësore	10.99	9.01	11.46	+27.19%
Granti për shëndetësi	82.97	86.92	85.86	–1.22%
Financimi për Shëndetësi Sekondare	2.60	2.60	2.90	+11.54%
Buxheti për Arsim	**384.96**	**400.80**	**414.70**	**+3.47%**
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	99.96	107.05	112.72	+5.30%
ASHAK	1.72	1.95	2.04	+4.62%
Universiteti i Prishtinës	34.15	35.19	38.46	+9.29%
Granti për Arsim i Komunave	249.13	256.60	261.47	+1.90%

Burimi: Projekt ligjet për ndarjet buxhetore: 2025 – 2027

3

MJEDISI BIZNESOR

3. MJEDISI BIZNESOR

Hulumtimi ynë, i realizuar në tetor 2026 me mbi 200 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), tregon për rritje të shqetësimeve të komunitetit të biznesit lidhur me disa nga parakushtet thelbësore të veprimtarisë së tyre. Nga 22 barrierat e përfshira në vlerësim (shih tabelën 12), 11 kanë shënuar rritje të intensitetit krahasuar me vitin 2025, 10 kanë shënuar rënie, ndërsa një ka mbetur e pandryshuar. Megjithatë, ndryshimet nuk janë të njëtrajtshme. Përkeqësimi është më i theksuar te faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt në kostot e operimit, sigurimin e fuqisë punëtore dhe aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve, ndërsa përmirësimet lidhen kryesisht me disa barriera administrative dhe infrastrukturore.

Furnizimi me energji elektrike për vitin 2026 është identifikuar si barriera me intensitetin më të lartë, prej 70 pikësh nga 100 maksimale e me një rritje të ndjeshme krahasuar me 50 pikë në vitin 2025. Kjo pasqyron faktin se energjia elektrike është shndërruar në një shqetësim gjithnjë e më të madh për ndërmarrjet, për shkak të ndikimit në kostot operative dhe parashikueshmërinë e tyre. Ngjashëm me këtë, OECD (2026) konstaton se kalimi i bizneseve në tregun e hapur të energjisë elektrike ka prekur mbi 1,000 ndërmarrje, të cilat janë përballur me rritje të kostove të prodhimit.[19] Për më tepër, përfshirja e kufizuar e bizneseve në konsultimet gjatë këtij procesi ka ndikuar gjithashtu në përgatitjen e tyre për kushtet e reja të furnizimit, duke shtuar pasigurinë lidhur me kostot dhe vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik. Krahas këtyre zhvillimeve, Banka Botërore (2026) gjithashtu evidenton se pasiguria në furnizim dhe kufizimet strukturore të sektorit energjetik vazhdojnë të ndikojnë në veprimtarinë e ndërmarrjeve.[20]

Gjatë vitit 2025, prodhimi i përgjithshëm vendor i energjisë elektrike ra me 12.63%, duke arritur në 5,298 GWh, krahasuar me rreth 6,064 GWh në vitin 2024.[21] Kjo rënie nxjerr në pah ndjeshmërinë e sistemit energjetik ndaj disponueshmërisë së kapaciteteve ekzistuese gjeneruese dhe ndërprerjeve për mirëmbajtje, duke theksuar njëkohësisht nevojën për investime që përmirësojnë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit.

Në vitin 2025, ndërkohë që prodhimi vendor u zvogëlua, kërkesa kombëtare për energji elektrike u rrit me 5.04%. Si pasojë, importet e energjisë elektrike shënuan rritje prej rreth 42% një rritje të vlerës së përafërt te vlerës së që shtoi presionin mbi kostot e sektorit prodhues , sidomos te bizneseve që iu nënshtruan procesit të liberalizimit. Të dhënat më të fundit të ASK-se tregojnë se gjatë periudhës janar–gusht 2026, konsumi i energjisë elektrike arriti në 3,836 GWh, duke shënuar rritje prej 4.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Rritja e konsumit ishte veçanërisht e theksuar në industri (12.3%) dhe në sektorin komercial (6.0%). Në këto kushte rritja e tarifave të rregulluara prej 16.1% në maj 2025, sipas vendimit tarifor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), dhe njëkohësisht heqjen nga tregu i rregulluar i rreth 1200 bizneseve të rëndësishme dhe ballafaqimi i tyre jo sa duhet i përgatitur me kushte tjera furnizimi, në një treg jo sa duhet konkurrent përbën një nga zhvillimet e rëndësishme të kësaj periudhe . Andaj kjo pasqyrohet në faktin se furnizimi me energji përbën barrierën me ndikimin më të madh negativ.(Shih rastin e përshkruar në Box, kuti më poshtë)

19 Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). (2026). Indeksi i politikave për NVM-të në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi 2026 – Profili ekonomik i Kosovës. OECD Publishing. https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2026/06/sme-policy-index-for-western-balkans-and-turkiye-2026-economy-profile-for-kosovo_6206d758/5737889a-en.pdf

20 Banka Botërore. (2026). Diagnostikimi i sektorit privat në Kosovë. (Kosova: Diagnostifikimi i sektorit privat të vendit.) https://www.ifc.org/content/dam/ifc/doc/2026/kosovo-private-sector-diagnostic-en.pdf

21 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). (2026). *Raporti Vjetor 2025*.

Në përgjithësi, zhvillimet e viteve 2025-2026 tregojnë se sfida kryesore e Kosovës nuk është vetëm sigurimi i energjisë së mjaftueshme, por edhe krijimi i një sistemi energjetik më efikas, financiarisht të qëndrueshëm dhe ekonomikisht të përballueshëm. Për mjedisin biznesor, kjo nënkupton nevojën për kushte më të qëndrueshme dhe të parashikueshme të furnizimit, të cilat u mundësojnë ndërmarrjeve të planifikojnë shpenzimet, të ruajnë konkurrueshmërinë dhe të realizojnë investime afatgjata.

Përtej sektorit energjetik, rezultatet e anketës së Institutit Riinvest tregojnë se bizneset vazhdojnë të përballen edhe me sfida të konsiderueshme në tregun e punës. Intensiteti i migrimit të fuqisë punëtore u rrit nga 55 pikë në vitin 2025 në 67 pikë në vitin 2026, ndërsa ai i aftësive dhe arsimimit të punëtorëve u rrit nga 52 në 66 pikë. Rritja paralele e këtyre dy barrierave tregon se ndërmarrjet përballen me vështirësi si në sigurimin e fuqisë punëtore, ashtu edhe në gjetjen e punëtorëve me aftësitë e nevojshme. Ndonëse migrimi mbetet nën nivelin maksimal prej 75 pikësh të regjistruar në vitin 2023, aftësitë dhe arsimimi kanë arritur nivelin më të lartë të periudhës së analizuar. Këto gjetje përputhen me vlerësimet e Bankës Botërore (2026), sipas së cilës përqindja e ndërmarrjeve që identifikojnë fuqinë punëtore me arsimim të papërshtatshëm si pengesën kryesore është rritur mbi gjashtëfish krahasuar me vitin 2019. Sipas këtij raporti, vështirësitë në sigurimin e punëtorëve të kualifikuar lidhen me emigrimin dhe me mospërputhjen ndërmjet aftësive që ofron sistemi i arsimit dhe aftësimit profesional dhe kërkesave të tregut të punës.

Një tjetër shqetësim i rëndësishëm për bizneset mbetet evazioni fiskal dhe informaliteti, intensiteti i të cilëve arriti në 66 pikë në vitin 2026, krahasuar me 52 pikë në vitin paraprak. Kjo paraqet një rritje prej 14 pikësh dhe nivelin më të lartë të regjistruar gjatë periudhës së analizuar. Informaliteti vazhdon të shihet si pengesë për konkurrencën e drejtë ndërmjet ndërmarrjeve, pasi bizneset që i përmbushin detyrimet ligjore mund të përballen me kosto më të larta sesa ato që veprojnë në mënyrë informale. Ngjashmen edhe sipas raportit të fundit Komisionit Evropian për Kosovën (2026), konstaton se ndonëse ekonomia informale është zvogëluar, ajo vazhdon të përbëjë një kufizim për zhvillimin e sektorit privat.

Shpenzimet e larta të financimit kanë shënuar përkeqësim, me rritje të intensitetit nga 53 pikë në vitin 2025 në 64 pikë në vitin 2026. Ndërkohë, intensiteti i barrierës së qasjes në kredi u rrit nga 46 në 51 pikë. Në një perspektivë më afatgjatë, shqetësimet për shpenzimet e financimit janë kthyer në nivelin e vitit 2023, ndërsa qasja në kredi mbetet relativisht më pak problematike sesa në atë periudhë. Sipas OECD-së (2026), financimi bankar në Kosovë mbështetet nga mekanizmat e garancisë kreditore, por alternativat jobankare vazhdojnë të jenë të pazhvilluara. Kjo kufizon mundësitë e ndërmarrjeve për zgjerim dhe investime, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme.

Përkeqësim është vërejtur edhe te barrierat institucionale. Intensiteti i korrupsionit u rrit nga 43 pikë në vitin 2025 në 54 pikë në vitin 2026, ai i ligjeve dhe sistemit gjyqësor nga 43 në 51 pikë, ndërsa siguria dhe stabiliteti politik nga 47 në 54 pikë. Sipas Komisionit Evropian (2026), dobësitë në zbatimin e ligjit, korrupsioni dhe paparashikueshmëria rregullatore vazhdojnë ta ngadalësojnë zhvillimin e sektorit privat. OECD-ja (2026), e cituar edhe nga Komisioni Evropian, raporton se rastet tregtare në shkallën e parë dhe të dytë zgjasin mesatarisht 631 ditë, ose rreth një vit e nëntë muaj. Kjo tregon se, pavarësisht themelimit të Gjykatës Komerciale, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mbetet sfidë për bizneset, duke krijuar pasiguri juridike dhe kosto shtesë në zgjidhjen e kontesteve tregtare.

Në anën tjetër, disa barriera që lidhen me administrimin dhe rregullimin e aktivitetit ekonomik kanë shënuar përmirësime të dukshme. Intensiteti i barrierës së normave tatimore ra nga 53 pikë në vitin 2025 në 44 pikë në vitin 2026, ndërsa ai i administratës tatimore joefikase u zvogëlua nga 51 në 42 pikë. Të dy treguesit kanë arritur nivelet më të ulëta të periudhës së analizuar, duke sugjeruar se barra tatimore dhe administrimi i saj perceptohen si shqetësime më të vogla krahasuar me vitet e mëparshme. Procedurat e licencimit shënuan rënie prej 10 pikësh, nga 44 në 34, ndërsa doganat nga 43 në 39 pikë. Sipas Komisionit Evropian (2026), thjeshtësimi dhe digjitalizimi i shërbimeve kanë kontribuar në uljen e kostove të përmbushjes së detyrimeve tatimore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Megjithatë, procedurat e gjata administrative dhe kapacitetet e kufizuara institucionale vazhdojnë të krijojnë vështirësi në marrjen e lejeve dhe licencave.

Përmirësimi më i madh gjatë vitit 2026 është regjistruar te transporti, intensiteti i të cilit ra nga 41 në 23 pikë. Kjo rënie sugjeron se transporti është bërë një pengesë më pak e theksuar në perceptimet e ndërmarrjeve. Telekomunikimi, ndërkohë, mbeti i pandryshuar në 21 pikë, duke vazhduar të jetë barriera me intensitetin më të ulët. Edhe gjetjet e Bankës Botërore (2026) tregojnë se transporti ka peshë relativisht të vogël krahasuar me pengesat e tjera të mjedisit biznesor. Ndryshime më të kufizuara u regjistruan te shkelja e kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit, intensiteti i së cilës u rrit nga 49 në 50 pikë, zhvillimet e shpejta teknologjike nga 46 në 47 pikë dhe barrierat jotarifore nga 43 në 46 pikë. Këta tregues kanë ruajtur nivele relativisht të qëndrueshme gjatë dy viteve të fundit.

Tabela 12. Perceptimi i bizneseve për pengesat e të bërit biznes

Pershkrimi/ viti	2023	2024	2025	2026
Furnizimi me energji elektrike	57	39	50	70
Migrimi i punëtorëve	75	64	55	67
Evazioni fiskal dhe informaliteti	64	65	52	66
Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve	55	60	52	66
Shpenzimet e larta të financimit (norma të larta interesi)	64	57	53	64
Korrupsioni	60	59	43	54
Siguria dhe stabiliteti politik	58	44	47	54
Qasja në kredi	58	51	46	51
Ligjet dhe sistemi gjyqësor	55	47	43	51
Shkelja e kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit	–	48	49	50
Ndryshimet e shpejta teknologjike	–	42	46	47
Barrierat jotarifore	–	44	43	46
Normat tatimore	64	52	53	44
Administrata tatimore joefikase	63	52	51	42
Qasja në informacione për ndërmarrjen	55	40	45	41
Standardet e prodhimit	–	43	44	41
Doganat	61	47	43	39
Qasja në tokë	–	44	44	34
Procedurat e licencimit	–	40	44	34
Ligji dhe rregulloret e punës	–	38	43	33
Transporti	51	36	41	23
Telekomunikimi	21	21	21	21

Burimi: Instituti Riinvest, anketat e bizneseve mbi barrierat e mjedisit biznesor (2017, 2023, 2024, 2025 dhe 2026).

Një gjetje tjetër është se industria përpunuese dhe prodhuese përfaqëson pjesën më të madhe të bizneseve që kanë investuar jashtë Kosovës. Ajo pasohet nga tregtia, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, si dhe transporti dhe magazinimi.

Ndër bizneset që planifikojnë të investojnë jashtë Kosovës, pasiguria politike dhe institucionale përmendet nga 65.5% e tyre, mungesa e incentivave nga 44.8%, tatimet më të favorshme nga 34.5%, krimi dhe korrupsioni nga 27.6%, ndërsa mundësia e konfliktit me Serbinë dhe sundimi i ligjit përmenden secila nga 20.7%. Krahasuar me bizneset që tashmë kanë realizuar investime jashtë vendit, ndërmarrjet që planifikojnë investime të ardhshme i japin rëndësi dukshëm më të madhe pasigurisë institucionale.

Analiza e faturave të energjisë elektrike të ndërmarrjeve prodhuese Abi SH.P.K. dhe Abi Progress 2000 SH.P.K. nxjerr në pah një zhvillim veçanërisht shqetësues për qëndrueshmërinë e prodhimit vendor dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë së Kosovës. Gjatë periudhës gusht–tetor 2026, konsumi i energjisë elektrike i këtyre ndërmarrjeve u rrit me vetëm 6.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, ndërsa vlera e faturave u rrit me 27.2%, duke arritur në afro 560 mijë euro. Edhe më alarmues është zhvillimi gjatë tetorit 2026, kur kostoja mesatare e faturuar e energjisë, përfshirë tarifat e rrjetit dhe TVSH-në, arriti në rreth 30.8 centë/kWh, krahasuar me 19.7 centë/kWh një vit më parë. Një rritje e tillë e kostos për njësi, dukshëm më e lartë se ndryshimi i konsumit, përbën sinjal serioz se ndërmarrjet prodhuese po përballen me një barrë financiare që mund të cenojë drejtpërdrejt qëndrueshmërinë e aktivitetit të tyre ekonomik. Në këto kushte, energjia elektrike rrezikon të shndërrohet nga një input bazë i prodhimit në një faktor që kufizon vetë aftësinë e ndërmarrjeve për të prodhuar, investuar dhe konkurruar.

Këto zhvillime ngrenë shqetësime thelbësore për mënyrën se si po funksionon tregu i liberalizuar i energjisë elektrike dhe për përgjegjësinë institucionale në mbrojtjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore. Kalimi formal në tregun e lirë nuk mund të konsiderohet sukses i reformës nëse nuk shoqërohet me konkurrencë efektive, transparencë të formimit të çmimeve dhe mundësi reale për bizneset që të zgjedhin ndërmjet ofertave konkurruese Ndonëse faturat e dy ndërmarrjeve nuk mjaftojnë për të përcaktuar shkaktarët e plotë të shtrenjtimit apo për të përgjithësuar rezultatet për të gjitha bizneset, ato përbëjnë një sinjal paralajmërues që nuk duhet trajtuar si problem individual i një prodhuesi, por si arsye për të hetuar nëse kushtet aktuale të tregut po krijojnë rreziqe më të gjera për industrinë vendore.

Abi SH.P.K. dhe Abi Progress 2000 SH.P.K. (2026) *Të dhëna mbi konsumin dhe kostot e energjisë elektrike, gusht–tetor 2025 dhe 2026.* Të dhëna të publikuara nga pronari i ndërmarrjeve.

4

TRANSFORMIMI DEMOGRAFIK DHE IMPLIKIMET PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

4. TRANSFORMIMI DEMOGRAFIK DHE IMPLIKIMET PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

4.1. Transformimi demografik i Kosovës: popullsia, plakja dhe migrimi

Kosova po hyn në një fazë të re të zhvillimit demografik, të karakterizuar nga zvogëlimi i popullsisë rezidente, rënia e numrit të lindjeve, emigrimi i vazhdueshëm dhe plakja graduale e popullsisë. Këto zhvillime përfaqësojnë një ndryshim të rëndësishëm krahasuar me periudhat e mëparshme, kur struktura relativisht e re e popullsisë konsiderohej një nga përparësitë kryesore të vendit për zhvillim ekonomik. Megjithëse Kosova vazhdon të ketë një popullsi relativisht të re në krahasim me shumicën e vendeve evropiane, ndryshimet e viteve të fundit tregojnë se ky avantazh demografik po zbehet gradualisht.

Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2024 ofrojnë dëshmitë më të plota për përmasat e këtij transformimi. Krahasuar me vitin 2011, popullsia rezidente ka shënuar rënie, numri absolut i personave në moshë pune është zvogëluar, ndërsa popullsia e moshës 65 vjeç e lart është rritur ndjeshëm. Njëkohësisht, kanë ndryshuar struktura e ekonomive familjare dhe shpërndarja territoriale e popullsisë, duke krijuar sfida të reja për tregun e punës, shërbimet publike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike (ASK, 2024; Instituti Riinvest, 2026).

4.1.1 Rënia e popullsisë dhe ndryshimi i strukturës demografike

Ndërmjet dy regjistrimeve të fundit, popullsia rezidente e Kosovës është zvogëluar nga rreth 1.74 milion banorë në vitin 2011 në rreth 1.60 milion në vitin 2024 (ASK, 2024). Kjo prirje ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, kur, sipas vlerësimeve më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK, 2026), popullsia rezidente në fund të vitit arriti në 1,582,322 banorë. Zvogëlimi i popullsisë pasqyron kryesisht ndikimin e emigrimit të vazhdueshëm, të shoqëruar me rënien e lindshmërisë dhe ndryshimet graduale në strukturën sipas moshës.

Sipas ASK-së (2026), gjatë vitit 2025, shtimi natyror i popullsisë ishte pozitiv, me 11,234 persona më shumë të lindur sesa të vdekur. Në të njëjtën periudhë, nga Kosova emigruan 29,656 persona, ndërsa 15,154 imigruan në vend, duke rezultuar në një bilanc negativ të migrimit ndërkombëtar prej 14,502 banorësh. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, popullsia rezidente e Kosovës u zvogëlua për 3,268 banorë gjatë vitit 2025 (ASK, 2026).

Këto të dhëna konfirmojnë se emigrimi mbetet faktori kryesor i zvogëlimit të popullsisë së Kosovës. Megjithëse shtimi natyror vazhdon të jetë pozitiv, ai nuk është i mjaftueshëm për të kompensuar humbjet nga migrimi ndërkombëtar. Në perspektivë afatgjatë, rënia e lindshmërisë dhe emigrimi i personave në moshë riprodhuese mund të përshpejtojnë plakjen e popullsisë dhe të dobësojnë më tej potencialin e shtimit natyror. Megjithatë, zvogëlimi relativisht i kufizuar i popullsisë gjatë vitit 2025 tregon se dinamika e migrimit mund të ndryshojë nga viti në vit, duke ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e tkurrjes demografike.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm lidhet me strukturën e ekonomive familjare. Madhësia mesatare e ekonomisë familjare është zvogëluar nga 5.9 anëtarë në vitin 2011 në 4.33 në vitin 2024, ndërsa numri i ekonomive famil-

jare është rritur nga 297,090 në 366,595 (ASK, 2024). Kjo nënkupton se, pavarësisht zvogëlimit të popullsisë, kërkesa për njësi banimi dhe infrastrukturë përkatëse nuk zvogëlohet domosdoshmërisht në të njëjtën masë.

4.1.2 Ndryshimi i piramidës demografike dhe plakja e popullsisë

Ndryshimet në strukturën sipas moshës paraqesin një nga aspektet më të rëndësishme të transformimit demografik të Kosovës. Krahasimi i piramidave demografike të viteve 2011 dhe 2024 tregon një ngushtim të dukshëm të bazës së piramidës, që pasqyron zvogëlimin e grupmoshave të reja, si dhe rritjen relative të pjesëmarrjes së grupmoshave të mesme dhe të vjetra.

Sipas analizës së Institutit Riinvest (2026), bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullësisë, pjesëmarrja e popullsisë nën moshën 30 vjeç ka rënë nga rreth 55 për qind në vitin 2011 në 45 për qind në vitin 2024. Ky ndryshim prej dhjetë pikësh përqindjeje brenda trembëdhjetë vjetëve dëshmon se struktura demografike e Kosovës po largohet gradualisht nga modeli tradicional i një popullsie të re dhe në zgjerim. Një faktor që kontribuon në këtë ndryshim është rënia e fertilitetit, i cili në vitin 2024 vlerësohej në 1.54 fëmijë për grua, dukshëm nën nivelin e zëvendësimit të gjeneratave prej rreth 2.1 fëmijësh (Banka Botërore, 2026).

Figura 6. Piramidat demografike të Kosovës, 2011 dhe 2024



Burimi: Instituti Riinvest (2026), bazuar në të dhënat e regjistrimeve të popullsisë të ASK-së.

Ngushtimi i bazës së piramidës ka implikime të drejtpërdrejta për ofertën e ardhshme të punës. Gjeneratat më të vogla që aktualisht hyjnë në sistemin arsimor do të përkthehen gradualisht në një numër më të vogël të të rinjve që hyjnë në tregun e punës. Në mungesë të ndryshimeve kompensuese në pjesëmarrjen në tregun e punës, migrim apo produktivitet, kjo pririe do të kufizojë potencialin e zgjerimit të punësimit dhe të prodhimit në afat të gjatë.

Paralelisht me zvogëlimin e grupmoshave të reja, Kosova po përjeton rritje të popullsisë së moshuar. Numri i personave të moshës 65 vjeç e lart është rritur nga 116,785 në vitin 2011 në 173,875 në vitin 2024, ose për rreth 49 për qind. Pjesëmarrja e kësaj grupmoshe në popullsinë e përgjithshme është rritur nga 6.7 në rreth 11 për qind (ASK, 2024).

Ky përkeqësim pasqyrohet edhe në treguesit e varësisë demografike. Raporti i përgjithshëm i varësisë ka rënë nga rreth 53 persona në moshë të varur për çdo 100 persona në moshë pune në vitin 2011, në 49 në vitin 2024. Megjithatë, raporti i varësisë së të moshuarve është rritur nga 11 në 17 gjatë së njëjtës periudhë. Ndërkohë, indeksi i plakjes, i cili mat numrin e personave të moshës 65 vjeç e lart për çdo 100 fëmijë të moshës 0–14 vjeç, është rritur nga 24 në 51 (Instituti Riinvest, 2026).

Këto zhvillime tregojnë se Kosova ndodhet në një fazë kyçe të një tranzicioni të sforcuar demografik. Rënia e numrit të fëmijëve ka kompensuar deri më tani rritjen e popullsisë së moshuar në raportin e përgjithshëm të varësisë. Megjithatë, me kalimin e kohës, plakja e popullsisë pritet të ushtrojë presion gjithnjë e më të madh mbi sistemin pensional, shërbimet shëndetësore dhe kujdesin afatgjatë.

Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është se pjesëmarrja relativisht e lartë e popullsisë në moshë pune nuk nënkupton domosdoshmërisht shfrytëzim të lartë të potencialit ekonomik. Në Kosovë, një pjesë e konsiderueshme e personave në moshë pune mbetet jashtë tregut të punës, veçanërisht gratë. Për këtë arsye, raportet demografike të varësisë nuk duhet të barazohen me raportet e varësisë ekonomike. Kjo çështje do të trajtohet më hollësisht në seksionin 4.2.

4.1.3 Migrimi si faktor përcaktues i ndryshimeve të pavolitshme demografike

Emigrimi vazhdon të jetë faktori kryesor i zvogëlimit të popullsisë së Kosovës. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në numrin e banorëve, migrimi ndikon në strukturën sipas moshës, ofertën e punës, formimin e familjeve dhe potencialin e ardhshëm të shtimit natyror. Kjo ndodh sepse një pjesë e konsiderueshme e emigrantëve u përket grupmoshave të reja dhe atyre në moshë pune.

Sipas FMN-së (2025), rreth një e treta e personave të lindur në Kosovë jetojnë jashtë vendit. Diferencat e konsiderueshme në paga dhe mundësi punësimi ndërmjet Kosovës dhe vendeve të Evropës Perëndimore vazhdojnë të jenë faktorë të rëndësishëm shtytës të emigrimit. Gjermania dhe Zvicra mbeten ndër destinacionet kryesore të diasporës kosovare (Riinvest, 2023).

Të dhënat e Eurostat (2026), tregojnë se gjatë vitit 2025 gjithsej 43,747 shtetas të Kosovës kanë marrë leje qëndrimi të parë në vendet e Bashkimit Evropian. Rreth 65 për qind e këtyre lejeve janë lëshuar nga Gjermania, ndërsa 73 për qind e përfituesve ishin të moshës 34 vjeç ose më të rinj. Më shumë se gjysma e lejeve ishin dhënë për arsye familjare. Kjo sugjeron se emigrimi po merr gjithnjë e më shumë karakterin e zhvendosjes familjare dhe të vendosjes afatgjatë, përtej migrimit të përkohshëm për punësim.

Nga këndvështrimi ekonomik, emigrimi ka efekte të dyfishta. Nga njëra anë, remitencat dhe lidhjet me diasporën mbështesin konsumin, mirëqenien e familjeve, investimet dhe qasjen në tregjet ndërkombëtare. Nga ana tjetër, largimi i personave në moshë pune dhe i profesionistëve të kualifikuar kufizon ofertën vendore të punës dhe mund të thellojë mungesat e shkathtësive në sektorë të caktuar (Riinvest, 2025; FMN, 2025; Banka Botërore, 2026).

Një zhvillim relativisht i ri është rritja e imigrimit drejt Kosovës për qëllime punësimi. Sipas projekt-Strategjisë së Migracionit 2026–2030, numri i lejeqëndrimeve të lëshuara për qëllime punësimi është rritur nga 2,122 në vitin 2021 në 5,087 në vitin 2025 (Qeveria e Kosovës, 2026). Kjo pririe pasqyron përpjekjet e bizneseve vendore për të

adresuar mungesat e fuqisë punëtore përmes rekrutimit nga jashtë.

Megjithatë, imigrimi për punësim mbetet i kufizuar në krahasim me përmasat e emigrimit. Për rrjedhojë, ai nuk mund të konsiderohet zëvendësues i plotë i fuqisë punëtore që largohet nga vendi. Për më tepër, rritja e punësimit të shtetasve të huaj, në një ekonomi ku një pjesë e madhe e popullsisë vendore mbetet ekonomikisht joaktive, nxjerr në pah probleme më të thella strukturore që lidhen me shkathtësitë, kushtet e punës, pagat dhe përputhjen ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë.

Në këtë kontekst, migrimi duhet të trajtohet jo vetëm si sfidë demografike, por edhe si komponent i rëndësishëm i politikave ekonomike. Ndërsa emigrimi mund të vazhdojë për shkak të dallimeve në të ardhura dhe mundësi ekonomike, ndikimi i tij mund të zbutet përmes rritjes së produktivitetit, përmirësimit të kushteve të punës dhe angazhimit më efektiv të diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit.

Sfida kryesore ekonomike nuk është vetëm zvogëlimi i popullsisë, por edhe aftësia e një fuqie punëtore potencialisht më të vogël për të mbështetur rritjen ekonomike dhe konvergjencën e të ardhurave. Implikimet e kësaj sfide analizohen në seksionin vijues.

4.2. Implikimet ekonomike: oferta e punës, pjesëmarrja dhe produktiviteti

Tranzicioni demografik po kufizon gradualisht potencialin e zogëlimit të rritjes numerike të fuqisë punëtore. Megjithatë, ndikimi në prodhim nuk është i paracaktuar: ai varet nga pjesëmarrja në tregun e punës, punësimi dhe produktiviteti. PVB-ja mund të shprehet si produkt i numrit të të punësuarve dhe prodhimit mesatar për të punësuar. Prandaj, edhe me popullsi në moshë pune më të vogël, ekonomia mund të rritet nëse punëson një pjesë më të madhe të saj dhe rrit produktivitetin për punëtor.

4.2.1. Oferta e punës dhe rezervat e pashfrytëzuara

Transformimi demografik i Kosovës, i karakterizuar nga zvogëlimi i popullsisë dhe plakja graduale e saj, e bën gjithnjë e më të rëndësishëm shfrytëzimin e potencialit ekzistues të fuqisë punëtore. Në këtë kontekst, një nga sfidat kryesore ekonomike nuk është vetëm zvogëlimi i numrit të personave në moshë pune, por edhe niveli i ulët i pjesëmarrjes së tyre në aktivitetin ekonomik. Rritja e punësimit, veçanërisht e grave dhe grupeve të tjera ekonomikisht joaktive, përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të zbutur ndikimin e zhvillimeve të pafavorshme demografike në rritjen ekonomike.

Sipas Anketës së fundit të Fuqisë Punëtore (2024), norma e punësimit të popullsisë 15–64 vjeç ishte 38.6 për qind, me dallime të theksuara gjinore. Norma e punësimit për burrat ishte 55.9 për qind, krahasuar me vetëm 21.2 për qind për gratë. Dallime edhe më të mëdha vërehen në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore, ku norma për burrat ishte 60.6 për qind, ndërsa për gratë 25.9 për qind, duke krijuar një hendek prej 34.7 pikësh përqindjeje (ASK, 2025b). Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e potencialit njerëzor të Kosovës mbetet e pashfrytëzuar.

Rreth 610 mijë persona në moshë pune ishin ekonomikisht joaktivë në vitin 2024 (ASK, 2025b). Megjithatë, kjo kategori nuk përfaqëson një rezervë homogjene të punëtorëve potencialë që mund të aktivizohen menjëherë. Ajo përfshin studentë, persona me përgjegjësi familjare dhe të kujdesit, individë me kufizime shëndetësore, persona të dekurajuar dhe grupe të tjera që nuk kërkojnë aktivisht punë. Për rrjedhojë, mobilizimi i këtij potenciali kërkon politika të diferencuara, të cilat adresojnë pengesat specifike të secilit grup, përtej masave tradicionale të ndërmjetësimit për të papunët e regjistruar.

Pjesëmarrja veçanërisht e ulët e grave përbën një nga kufizimet më të rëndësishme strukturore të tregut të punës. Ajo lidhet me ndërthurjen e shumë faktorëve, përfshirë përgjegjësitë e papaguara të kujdesit, mungesën e shërbimeve të përballueshme për fëmijë dhe të moshuar, kushtet e punës dhe pengesat në zhvillimin profesional.

Për këtë arsye, politikat e aktivizimit duhet të synojnë jo vetëm hyrjen e grave në tregun e punës, por edhe qëndrueshmërinë e punësimit gjatë periudhave të krijimit të familjes dhe mundësitë e avancimit në karrierë (Hashani et al., 2025).

Studimi i Institutit Riinvest, i realizuar në bashkëpunim me UNFPA-në, vlerëson përfitimet potenciale makroekonomike nga zvogëlimi i hendekëve gjinorë në tregun e punës. Duke përdorur Indeksin e Hendekut Gjinor në Punësim (GEGI), studimi vlerëson se barazimi i pjesëmarrjes së grave dhe burrave në fuqinë punëtore mund të shoqërohet me një rritje potenciale afatgjatë të PVB-së për banor prej 5.9 për qind. Në skenarin e mbylljes së hendekut gjinor në punësim, përfitimi potencial arrin në 19.4 për qind, ndërsa përfshirja edhe e dallimeve në llojin e punës e rrit atë në 21.1 për qind (Hashani et al., 2025).

Këto vlerësime tregojnë se aktivizimi i potencialit të pashfrytëzuar të fuqisë punëtore mund të zbusë pjesërisht ndikimin e zhvillimeve të pafavorshme demografike dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike. Megjithatë, realizimi i këtij potenciali kërkon jo vetëm rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës, por edhe krijimin e vendeve të punës cilësore dhe produktive. Në këtë drejtim, politikat duhet të adresojnë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen ekonomike. Prioritetet përfshijnë zgjerimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë dhe të moshuar, përmirësimin e kushteve dhe fleksibilitetit të punës, aftësimin profesional dhe zvogëlimin e diskriminimit. Investimet në shërbimet e kujdesit kanë përfitime të dyfishta: mundësojnë pjesëmarrje më të lartë në tregun e punës dhe krijojnë drejtpërdrejt vende të reja pune (Hashani et al., 2025).

Përtej zgjerimit të shërbimeve të kujdesit dhe përmirësimit të kushteve të punës, një instrument tjetër i rëndësishëm për rritjen e pjesëmarrjes ekonomike të grave është reformimi i kuadrit ligjor për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror. Një studim i Institutit Riinvest (2026), i realizuar në bashkëpunim me Forumin Ekonomik të Grave (FEG), evidenton se modeli aktual i financimit të pushimit të lehonisë në Kosovë vendos një barrë të konsiderueshme financiare mbi punëdhënësit, duke krijuar potencialisht stimuj negativë për punësimin dhe mbajtjen në punë të grave në moshë riprodhuese. Skemat ekzistuese të mbështetjes financiare për nënat përbëjnë një hap pozitiv, por efektiviteti i tyre mund të rritet përmes harmonizimit me dispozitat e Ligjit të Punës dhe rishikimit të mënyrës së financimit të pushimit të lehonisë. Një qasje më e integruar do të mundësonte shfrytëzim më efikas të burimeve publike, zvogëlim të barrës financiare për punëdhënësit dhe mbrojtje më të mirë të grave gjatë dhe pas pushimit të lehonisë.

Studimi simulon gjithashtu implikimet financiare të zbatimit në Kosovë të modeleve të pushimit të lehonisë dhe pushimit prindëror nga vendet e rajonit. Rezultatet tregojnë se, krahasuar me koston e vlerësuar të sistemit aktual, zbatimi i këtyre modeleve do të kërkonte një rritje të shpenzimeve të përgjithshme për kompensimin e pushimit prej rreth 37 deri në 111 për qind, varësisht nga modeli i përzgjedhur. Këto vlerësime, të cilat përfshijnë shpenzimet e shtetit dhe të punëdhënësve, tregojnë se reforma kërkon planifikim të kujdesshëm financiar, por njëkohësisht ofrojnë bazë për shqyrtimin e alternativave të financimit dhe rishpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet shtetit dhe punëdhënësve. Në kontekstin e zhvillimeve të pafavorshme demografike, reforma të tilla duhet të trajtohen jo vetëm si masa të mbrojtjes sociale, por edhe si investime në ruajtjen e kapitalit njerëzor, rritjen e pjesëmarrjes ekonomike të grave dhe mbështetjen e familjeve (Instituti Riinvest, 2026).

Krahas reformave në politikat familjare dhe të mbrojtjes sociale, shërbimet publike të punësimit duhet të zgjerojnë mbështetjen për personat ekonomikisht joaktivë, përmes identifikimit të pengesave individuale dhe bashkëpunimit me komunat, institucionet arsimore dhe punëdhënësit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi mungesat e raportuara të fuqisë punëtore nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mungesë absolute të punëtorëve, por mund të lidhen edhe me mospërputhjen e shkathtësive, kushtet e punës, pagat dhe kufizimet e mobilitetit. Adresimi i këtyre pengesave mund të përmirësojë njëkohësisht pjesëmarrjen ekonomike dhe përputhjen ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë.

Në kushtet e emigrimit dhe plakjes graduale të popullsisë, mobilizimi i fuqisë punëtore ekzistuese, i kombinuar me rritjen e produktivitetit, përbën një nga përgjigjet kryesore ekonomike ndaj sfidave demografike të Kosovës. Kjo kërkon që politikat e aktivizimit të trajtohen si pjesë përbërëse e strategjisë së rritjes dhe konvergjencës ekonomike, dhe jo vetëm si instrumente të politikës sociale apo të punësimit.

4.2.2. Kapitali njerëzor dhe mospërputhja e shkathtësive

Përveç madhësisë së fuqisë punëtore, rëndësi vendimtare për rritjen ekonomike ka cilësia e kapitalit njerëzor. Në kushtet e zvogëlimit të gjeneratave të reja, Kosova duhet të sigurojë që potenciali i tyre të zhvillohet dhe të shfrytëzohet sa më mirë. Kjo kërkon përmirësimin e cilësisë së arsimit, zhvillimin e shkathtësive që kërkon tregu i punës dhe krijimin e mundësive për punësim produktiv. Mangësitë në këto fusha bëhen veçanërisht të kushtueshme në një ekonomi që përballet me emigrim dhe plakje graduale të popullsisë.

Cilësia e arsimit mbetet një nga sfidat kryesore për zhvillimin e kapitalit njerëzor në Kosovë. Rezultatet e testit ndërkombëtar PISA 2025 tregojnë se nxënësit kosovarë kanë arritur mesatarisht 350 pikë në matematikë, 340 në lexim dhe 357 në shkencë, dukshëm nën mesataret e OECD-së prej përkatësisht 463, 461 dhe 482 pikësh. Krahasuar me vitin 2022, rezultatet kanë mbetur kryesisht të pandryshuara, duke treguar mungesë të përmirësimit të qëndrueshëm në rezultatet e të nxënit (OECD, 2026). Këto rezultate dëshmojnë se sfida nuk qëndron vetëm te përfshirja në arsim, por edhe te cilësia e njohurive dhe kompetencave që nxënësit fitojnë.

Investimet publike në kapitalin njerëzor përbëjnë një dimension tjetër të rëndësishëm. Sipas një vlerësimi të Bankës Botërore, shpenzimet publike për arsim dhe shëndetësi në Kosovë në vitin 2024 përfaqësonin përkatësisht rreth 4.1 dhe 3.9 për qind të PVB-së, krahasuar me mesataret e BE-së prej 4.7 dhe 7.6 për qind. Përtej nivelit të financimit, rëndësi ka edhe efikasiteti i shpenzimeve dhe orientimi i tyre drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimeve (Banka Botërore, 2026). Në kontekstin e ndryshimeve demografike, investimet në arsim dhe shëndetësi janë thelbësore jo vetëm për mirëqenien e popullsisë, por edhe për ruajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve produktive të fuqisë punëtore.

Njëkohësisht, Kosova vazhdon të përballet me mospërputhje ndërmjet shkathtësive të fuqisë punëtore dhe kërkesave të ndërmarrjeve. Sipas OECD-së (2024), 44.2 për qind e ndërmarrjeve në Kosovë e kanë identifikuar përgatitjen e papërshtatshme të fuqisë punëtore si pengesë madhore për aktivitetin e tyre, ndërsa 26 për qind e punëtorëve të rritur raportojnë se kanë nivel arsimimi më të lartë sesa kërkohet për vendin e tyre të punës. Këta tregues sugjerojnë se problemi nuk lidhet vetëm me mungesën e shkathtësive, por edhe me shfrytëzimin joefikas të kualifikimeve ekzistuese. Mungesat e punëtorëve në sektorë të caktuar nuk mund t'i atribuohen vetëm emigrimit, pasi ato mund të pasqyrojnë edhe paga dhe kushte pune jo konkurruese, mundësi të kufizuara të avancimit dhe pengesa në mobilitet (Riinvest, 2019).

Rëndësi të veçantë ka forcimi i lidhjeve ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës. Zgjerimi i praktikave profesionale, mësimit në vendin e punës dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe ndërmarrjeve mund të lehtësojë kalimin e të rinjve në punësim. Ndërkohë, përmirësimi i aftësimit profesional dhe mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës është i domosdoshëm për përshtatjen e punëtorëve ekzistues me ndryshimet teknologjike dhe kërkesat e reja të ekonomisë.

Në kushtet e transformimit demografik, përmirësimi i cilësisë së kapitalit njerëzor bëhet po aq i rëndësishëm sa rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës. Me gjenerata potencialisht më të vogla që hyjnë në tregun e punës, aftësia e Kosovës për të ruajtur rritjen ekonomike dhe për të përshpejtuar konvergjencën me BE-në do të varet gjithnjë e më shumë nga cilësia e arsimit, shëndeti i popullsisë dhe produktiviteti i punëtorëve.

4.2.3. Produktiviteti dhe konvergjenca ekonomike

Rritja e produktivitetit bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për konvergjencën ekonomike të Kosovës, në kushtet kur ndryshimet demografike kufizojnë mundësinë e zgjerimit të fuqisë punëtore. Me zvogëlimin e pritshëm të popullsisë në moshë pune, ruajtja e ritmit të rritjes ekonomike do të varet gjithnjë e më shumë nga aftësia për të krijuar më shumë vlerë të shtuar për çdo të punësuar. Kjo kërkon investime në teknologji, kapital njerëzor, inovacion dhe kalimin drejt aktiviteteve me vlerë më të lartë të shtuar dhe potencial më të madh eksportues.

Sipas OECD-së (2026), produktiviteti mesatar i punës në Ballkanin Perëndimor mbetet dukshëm nën nivelin e BE-së, ndërsa konvergjenca ka qenë e ngadalshme. Edhe pse ky është tregues rajonal, ai ilustron kufizimet e një modeli rritjeje që mbështetet kryesisht në konsum dhe rritje të pagave, pa zgjerim të mjaftueshëm të kapaciteteve prodhuese. Raporti i Institutit Riinvest dhe wiiw (2026) tregon se produktiviteti i punës në Kosovë, i matur si prodhim për të punësuar sipas standardit të fuqisë blerëse, arrin rreth 54 për qind të mesatares së BE-së, krahasuar me vetëm 29 për qind për PVB-në për banor. Megjithatë, përparimi në konvergjencën e produktivitetit mbetet i ngadalshëm. Kjo tregon se Kosova ka hapësirë të konsiderueshme për rritjen e prodhimit për punëtor, gjë që bëhet veçanërisht e rëndësishme në kushtet e një oferte potencialisht më të kufizuar të fuqisë punëtore.

Rritja e pagave duhet të shoqërohet me përmirësimin e produktivitetit, por kjo marrëdhënie kërkon interpretim të kujdesshëm. Pagat më të larta mund të pasqyrojnë korrigjimin e niveleve historikisht të ulëta ose mungesat e fuqisë punëtore, të cilat mund të bëhen më të theksuara si pasojë e emigrimit dhe zvogëlimit të gjeneratave të reja. Megjithatë, kur kostot e punës rriten vazhdimisht më shpejt se produktiviteti, konkurrueshmëria e ndërmarrjeve mund të dobësohet, veçanërisht në sektorët eksportues. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të marrë parasysh dallimet sektoriale, çmimet dhe strukturën e prodhimit, jo vetëm treguesit mesatarë.

Për Kosovën, politika industriale dhe ajo e inovacionit duhet të synojnë rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin e sektorëve me vlerë më të lartë të shtuar. Në kushtet kur rritja ekonomike do të mund të mbështetet gjithnjë e më pak në zgjerimin numerik të fuqisë punëtore, këto politika marrin rëndësi të veçantë. Kjo kërkon mbështetje transparente dhe të orientuar drejt rezultateve për investimet në makineri, teknologji, standarde të cilësisë, eksporte dhe bashkëpunim ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve kërkimore, pa u mbështetur në përzgjedhjen administrative të ndërmarrjeve fituese. Një pengesë e rëndësishme mbetet financimi i pamjaftueshëm i kërkimit dhe zhvillimit. Sipas Riinvest (2025), shpenzimet për kërkim dhe zhvillim në Kosovë ishin vetëm 0.02 përqind e PVB-së në vitin 2025, krahasuar rreth 0.5 përqind në rajon dhe me mbi 2 për qind në BE. Rritja graduale e këtij financimi, e shoqëruar me mekanizma konkurrues dhe bashkëpunim më të fortë ndërmjet akademisë dhe industrisë, duhet të jetë prioritet i politikave të zhvillimit ekonomik, duke kontribuar në shfrytëzimin më produktiv të kapitalit njerëzor ekzistues dhe në kompensimin e pjesshëm të ndikimeve të pafavorshme demografike.

Rritja e produktivitetit lidhet drejtpërdrejt edhe me migrimin, i cili përbën një nga faktorët kryesorë të transformimit demografik të Kosovës. Ndërmarrjet më produktive mund të ofrojnë paga më konkurruese, kushte më të mira pune dhe perspektiva më tërheqëse profesionale, duke zvogëluar disa nga nxitësit ekonomikë të emigrimit.[22] Ndonëse kjo nuk mund ta ndalë emigrimin, pasi vendimet për migrim ndikohen edhe nga faktorë familjarë dhe socialë, krijimi i vendeve të punës me produktivitet dhe vlerë të shtuar më të lartë përbën një përgjigje të rëndësishme ekonomike ndaj sfidave demografike të Kosovës. Në këtë mënyrë, përmirësimi i produktivitetit mund të kontribuojë njëkohësisht në përshpejtimin e konvergjencës ekonomike dhe në zbutjen e presioneve demografike që lidhen me emigrimin.

22 Te gjithë këta faktorë janë evidentuar si përcaktues domethënës që nxisin prirjen për migrim (Riinvest, 2023).

4.3. Perspektiva demografike dhe përgjigjet e politikave ekonomike

Ndryshimet demografike kërkojnë një përgjigje të koordinuar të politikave ekonomike, të përqendruar në aktivizimin e fuqisë punëtore, rritjen e produktivitetit, mbështetjen e familjeve dhe përshtatjen e institucioneve dhe shërbimeve publike. Këto politika duhet të adresojnë njëkohësisht sfidat aktuale të tregut të punës dhe ndikimet afatgjata të emigrimit, rënies së lindshmërisë dhe plakjes së popullsisë.

4.3.1. Prioriteti i parë: Aktivizimi dhe mbajtja e fuqisë punëtore

Në kushtet e zvogëlimit të pritshëm të popullsisë në moshë pune, aktivizimi i potencialit ekzistues njerëzor duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të politikave ekonomike. Kjo kërkon që politikat aktive të tregut të punës të shtrihen përtej personave të papunë të regjistruar, duke përfshirë edhe personat ekonomikisht joaktivë. Shërbimet e punësimit duhet të forcojnë identifikimin dhe kontaktimin e këtyre grupeve, përmes bashkëpunimit me komunat, punëdhënësit dhe institucionet e aftësimit profesional.

Rritja e pjesëmarrjes ekonomike të grave duhet të zërë vend qendror në këtë agjendë. Zgjerimi i shërbimeve të përballueshme dhe cilësore të kujdesit për fëmijë dhe të moshuar, përmirësimi i kushteve të punës dhe mundësitë për organizim fleksibil të saj mund të lehtësojnë hyrjen dhe qëndrimin e grave në punësim. Njëkohësisht, reformimi i politikave të pushimit të lehonisë dhe pushimit prindëror duhet të synojë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, duke shmangur krijimin e kostove dhe stimujve që mund të dekurajojnë punësimin e grave. Vlerësimet e Institutit Riinvest dhe UNFPA-së mbi përfitimet ekonomike nga zvogëlimi i hendekëve gjinorë tregojnë se këto ndërhyrje duhet të trajtohen si investime në rritjen ekonomike dhe jo vetëm si masa sociale (Hashani et al., 2025).

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet edhe të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo trajnim, si dhe personave që kanë ndërprerë aktivitetin ekonomik për shkak të përgjegjësive familjare. Për të rinjtë, prioritet duhet të jetë kalimi më i lehtë nga arsimi në punë, përmes praktikave profesionale dhe bashkëpunimit me ndërmarrjet. Për personat me përvojë pune, rëndësi kanë rikualifikimi, mundësitë për rikthim në punësim dhe përshtatja e kushteve të punës me nevojat individuale.

Efektiviteti i këtyre politikave duhet të matet përmes rezultateve të qëndrueshme në tregun e punës, përfshirë punësimin pas përfundimit të programeve, vazhdimësinë e punësimit, formalizimin dhe përparimin në paga. Kjo kërkon koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse për punësimin, arsimin, shërbimet e kujdesit dhe zhvillimin ekonomik, si dhe monitorim të diferencuar sipas gjinisë, moshës dhe komunës.

4.3.2. Prioriteti i dytë: Produktiviteti, kapitali njerëzor dhe transformimi strukturor

Përballë kufizimeve demografike të ofertës së punës, politikat ekonomike duhet të synojnë rritjen e vlerës së shtuar për çdo të punësuar. Siç është evidentuar më sipër, Kosova ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësimin e produktivitetit, por kjo kërkon ndryshime në përbërjen dhe efikasitetin e investimeve, përvetësimin e teknologjive dhe zhvillimin e aktiviteteve me potencial më të lartë eksportues.

Një prioritet është orientimi i investimeve drejt makinerive, pajisjeve, digjitalizimit dhe proceseve më efikase të prodhimit. Politikat industriale duhet të mbështesin ndërmarrjet që investojnë në modernizim, inovacion dhe zgjerim të eksporteve, përmes instrumenteve transparente dhe të lidhura me rezultate të matshme. Përmirësimi i qasjes në financim, konkurrencës dhe infrastrukturës mund të lehtësojë zgjerimin e ndërmarrjeve më produktive dhe kalimin e burimeve drejt aktiviteteve me vlerë më të lartë të shtuar.

Këto investime duhet të shoqërohen me përmirësimin e kapitalit njerëzor. Krahas rritjes së cilësisë së arsimit, rëndësi të veçantë merr zhvillimi i aftësive digjitale, rikualifikimi dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore dhe ndërmarrjeve duhet të orientohet drejt nevojave konkrete të tregut të punës, duke krijuar mundësi që punëtorët ekzistues të

përshtaten me ndryshimet teknologjike dhe kërkesat e reja profesionale.

Forcimi i sistemit të kërkimit dhe inovacionit duhet të jetë pjesë përbërëse e politikës së produktivitetit. Kjo kërkon rritje graduale të financimit për kërkim dhe zhvillim, mekanizma konkurrues për mbështetjen e projekteve me potencial ekonomik dhe bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet universiteteve, institucioneve kërkimore dhe sektorit privat. Angazhimi i diasporës shkencore dhe profesionale mund të kontribuojë në transferimin e njohurive, teknologjisë dhe praktikave të avancuara të menaxhimit.

Në këtë drejtim, integrimi më i thellë në tregjet rajonale dhe evropiane përbën një mundësi të rëndësishme. Mbështetja për certifikimin, standardet e cilësisë, lidhjet me blerësit ndërkombëtarë dhe përfshirjen në zinxhirët e vlerës mund të ndihmojë ndërmarrjet kosovare të kalojnë nga aktivitetet e orientuara kryesisht drejt tregut vendor në prodhim dhe shërbime më konkurruese.

4.3.3. Prioriteti i tretë: Migrimi, mbështetja e familjes dhe përshtatja e shërbimeve publike

Migrimi duhet të trajtohet si pjesë përbërëse e strategjisë së zhvillimit ekonomik dhe demografik të Kosovës. Duke qenë se lëvizshmëria ndërkombëtare pritet të vazhdojë, objektivi i politikave nuk duhet të jetë kufizimi administrativ i emigrimit, por krijimi i kushteve që e bëjnë qëndrimin, kthimin dhe investimin në Kosovë më tërheqës. Përmirësimi i mundësive të punësimit, pagave, cilësisë së shërbimeve publike dhe perspektivës profesionale është thelbësor në këtë drejtim.

Përtej remitencave, marrëdhëniet me diasporën duhet të orientohen më shumë drejt investimeve produktive, transferimit të njohurive dhe lidhjeve me tregjet ndërkombëtare. Programet për angazhimin e profesionistëve dhe studiuesve të diasporës, përfshirë projektet e përbashkëta kërkimore me institucionet vendore, bashkëpunimin me ndërmarrjet dhe mbështetjen e iniciativave ndërmarrëse, mund të krijojnë përfitime më të qëndrueshme ekonomike.[23] Njëkohësisht, politikat e kthimit duhet të lidhen me mundësi konkrete punësimi, zhvillimi profesional dhe investimi.

Përballë rënies së lindshmërisë dhe ndryshimeve në strukturën e popullsisë, Kosova duhet të zhvillojë politika më të qëndrueshme për mbështetjen e familjeve dhe krijimin e kushteve më të favorshme për rritjen e fëmijëve. Këto politika duhet të adresojnë pengesat ekonomike dhe sociale që ndikojnë në vendimet për krijimin dhe zgjerimin e familjes, përfshirë pasigurinë ekonomike, kostot e banimit, qasjen në shërbime të kujdesit për fëmijë dhe vështirësitë në harmonizimin e punës me përgjegjësitë familjare.

Mbështetja për familjet duhet të jetë e mirëdizajnuar, e qëndrueshme dhe e orientuar sipas nevojave, duke kombinuar përfitimet financiare me shërbime cilësore dhe të përballueshme. Masat e përgjithshme mund të plotësohen me mbështetje më të targetuar për familjet me të ardhura të ulëta, prindërit e rinj dhe familjet që përballen me pengesa më të mëdha ekonomike. Efektiviteti i tyre duhet të vlerësohet në raport me mirëqenien e familjeve, sigurinë ekonomike dhe mundësitë për pjesëmarrje në tregun e punës, e jo vetëm me numrin e përfituesve. Megjithatë, politikat familjare nuk duhet të shihen si instrument që mund ta përmbysë vetvetiu rënien e lindshmërisë, por si pjesë e një përgjigjeje më të gjerë ndaj transformimit demografik.

Në kushtet e mungesave të fuqisë punëtore në sektorë të caktuar, Kosova duhet të zhvillojë edhe një qasje më të strukturuar ndaj migrimit hyrës për qëllime punësimi. Rekrutimi i punëtorëve të huaj mund të ndihmojë në adresimin e mungesave të dokumentuara, por duhet të shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe me sisteme më të mira të të dhënave për punësimin dhe qëndrimin. Kjo politikë duhet të jetë plotësuese dhe jo zëvendësuese e përpjekjeve për aktivizimin e fuqisë punëtore vendore.

23 King dhe Gëdeshi (2026), në studimin *The New Scientific Diaspora from Kosova*, evidentojnë gatishmëri të lartë të diasporës shkencore për bashkëpunim me institucionet akademike dhe kërkimore në Kosovë. Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta kërkimore rezulton forma më e preferuar e bashkëpunimit, krahas ligjëratave, konferencave dhe publikimeve të përbashkëta.

Ndryshimet demografike kërkojnë gjithashtu përshtatjen graduale të shërbimeve publike. Plakja e popullsisë do të rrisë kërkesën për shërbime shëndetësore, kujdes afatgjatë dhe mbështetje për të moshuarit, ndërsa rritja e numrit të përfituesve të pensioneve bazike mund të shtojë presionet mbi buxhetin. Për këtë arsye, projeksionet demografike duhet të integrohen në planifikimin afatmesëm fiskal, duke marrë parasysh dallimet ndërmjet skemave pensionale të financuara nga buxheti dhe atyre të bazuara në kontribute individuale.

Dimensioni territorial i ndryshimeve demografike kërkon vëmendje të veçantë. Në komunat ku numri i fëmijëve dhe i banorëve zvogëlohet, mund të nevojitet përshtatja e rrjetit të shkollave dhe shërbimeve të tjera publike, duke ruajtur qasjen dhe cilësinë. Ndërkohë, në qendrat urbane që përjetojnë përqendrim të popullsisë, mund të rritet nevoja për investime në banim, transport, arsim parashkollor dhe infrastrukturë. Për rrjedhojë, shpërndarja e burimeve publike duhet të mbështetet gjithnjë e më shumë në projeksione demografike sipas komunave dhe grupmoshave, në vend të modeleve uniforme të planifikimit.

4.3.4. Përfundime dhe orientime strategjike

Analiza e Institutit Riinvest (2026), e bazuar në projeksionet demografike të ASK-së deri në vitet 2035 dhe 2050, sugjeron se Kosova do të përballet me një ndryshim të mëtejshëm të strukturës së popullsisë, të karakterizuar nga zvogëlimi i gjeneratave të reja, rritja e peshës së të moshuarve dhe presione të mundshme mbi popullsinë në moshë pune. Deri në vitin 2035, aktivizimi i potencialit ekzistues të fuqisë punëtore mund të zbusë një pjesë të ndikimeve ekonomike, ndërsa në horizontin deri në vitin 2050, efektet e plakjes dhe ndryshimeve në strukturën e moshës pritet të bëhen më të theksuara. Megjithatë, pasojat ekonomike nuk janë të paracaktuara, pasi ato do të varen nga niveli i emigrimit, pjesëmarrja në tregun e punës dhe rritja e produktivitetit. Kjo e bën të domosdoshme që politikat ekonomike dhe planifikimi i shërbimeve publike të marrin parasysh perspektivën afatgjatë demografike.

Përgjigjja strategjike duhet të kombinojë masa që japin rezultate në afat më të shkurtër, si rritja e pjesëmarrjes së grave dhe grupeve të tjera joaktive në tregun e punës, me reforma afatgjata në arsim, inovacion dhe transformim strukturor. Këto duhet të plotësohen me politika të mirëdizajnuara për mbështetjen e familjeve, menaxhimin e migrimit dhe përshtatjen e shërbimeve publike.

Zbatimi i kësaj agjende kërkon koordinim institucional dhe një kornizë të qartë monitorimi. Treguesit kryesorë duhet të përfshijnë pjesëmarrjen dhe punësimin sipas gjinisë dhe grupmoshave, produktivitetin e punës, migrimin neto, ndryshimet në strukturën e moshës dhe presionet mbi shërbimet publike. Monitorimi i rregullt do të mundësonte vlerësimin e rezultateve të politikave dhe përshtatjen e tyre me zhvillimet demografike.

Në përfundim, transformimi demografik nuk duhet të shihet vetëm si kufizim për zhvillimin, por edhe si nxitje për ndryshimin e modelit ekonomik të Kosovës. Kalimi drejt një ekonomie me pjesëmarrje më të lartë në tregun e punës, produktivitet më të madh, mbështetje më efektive për familjet dhe institucione më të përshtatura me strukturën e popullsisë përbën përgjigjen më të qëndrueshme ndaj sfidave demografike dhe një kusht të rëndësishëm për përshpejtimin e konvergjencës me Bashkimin Evropian.

REFERENCAT

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) (2026). *Të dhënat administrative mbi qarkullimin dhe punësimin, janar–shtator 2026*. Prishtinë: ATK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2011–2026). *Regjistrimet e popullsisë, anketat e fuqisë punëtore dhe seritë kohore statistikore mbi popullsinë, migrimin, llogaritë kombëtare, çmimet, tregtinë e jashtme dhe energjinë*. Prishtinë: ASK.

Banka Botërore (2026). *Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor, nr. 30, vjeshtë 2026: Nga hyrja në treg te qëndrueshmëria e eksporteve*. Uashington, DC: Banka Botërore.

Banka Botërore (2026). *Treguesit e Zhvillimit Botëror (World Development Indicators)*. Uashington, DC: Banka Botërore.

Banka Botërore (2026). *Kosova: Diagnostikimi i Sektorit Privat të Vendit (CPSD)*. Uashington, DC: Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Grupi i Bankës Botërore.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (2026). *Perspektivat Ekonomike Rajonale në Vendet ku Vepron BERZH-i, qershor 2026*. Londër: BERZH.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) (2019–2026). *Seritë kohore statistikore mbi inflacionin, sektorin monetar dhe financiar, bilancin e pagesave, tregtinë e shërbimeve, remitencat dhe investimet e huaja direkte*. Prishtinë: BQK.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) (2026). *Vlerësimi Tremujor Ekonomik, nr. 55, TM2 2026*. Prishtinë: BQK.

Eurostat (2026). *Lejet e para të qëndrimit të lëshuara për shtetasit jashtë BE-së: Të dhënat për vitin 2025*. Luksemburg: Eurostat.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (2025). *Integrimi në tregun e punës dhe migrimi, Republika e Kosovës*. Dokument për Çështje të Veçanta i FMN-së, nr. 2025/001. Uashington, DC: FMN.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (2026). *Republika e Kosovës: Konsultimet e vitit 2026 sipas Nenit IV – Njoftimi për shtyp, raporti i stafit, dokumenti plotësues i stafit dhe deklarata e Drejtorit Ekzekutiv për Republikën e Kosovës*. Raporti i FMN-së për vendin, nr. 26/79. Uashington, DC: FMN.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (2026). *Perspektiva Ekonomike Botërore, tetor 2026*. Uashington, DC: FMN.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) (2026). *Të dhënat mbi llogaritë e kontribuuesve aktivë, 2025–2026*. Prishtinë: FKPK.

Hashani, A. et al. (2025). *Zhbllokimi i potencialit: Kostoja ekonomike e potencialit të pashfrytëzuar të grave*. Prishtinë: Instituti Riinvest dhe UNFPA.

Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw) (2026). *Evropa Qendrore, Lindore dhe Juglindore në vitin 2027: Rritje rezistente në një botë më të rrezikshme*. Raporti i Parashikimeve i wiiw, vjeshtë 2026. Vjenë: wiiw.

Instituti Riinvest (2017–2026). *Anketat e bizneseve dhe studimet mbi barrierat e të bërit biznes në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2019). *Analiza e punësimit dhe tregut të punës (ELMA) dhe trajnimi në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2023). *Një model i ri për rritje të qëndrueshme ekonomike*. Forumi Ekonomik Vjetor 2023. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2024). *Tejkalimi i kurthit të rritjes së pamjaftueshme dhe rritja e efikasitetit të investimeve*. Forumi Ekonomik Vjetor 2024. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2025). *Zhvillimet ekonomike: Kërcënimet nga kriza institucionale*. Forumi Ekonomik Vjetor 2025. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2026). *Raporti Vjetor i Konvergjencës: Kosova 2026*. Converge2EU. Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw). Në dispozicion në: https://converge2.eu/reports

Instituti Riinvest (2026). *Regjistrimi i Popullsisë së Kosovës 2024: Analizë e implikimeve të ndryshimeve demografike për politikat dhe zhvillimin*. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2026). *Rishikimi i pushimit të lehonisë dhe pushimit prindëror në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Riinvest dhe Forumi Ekonomik i Grave (FEG).

King, R. dhe Gëdeshi, I. (2026). *Diaspora e re shkencore nga Kosova*. Prishtinë: Friedrich-Ebert-Stiftung (FES).

Komisioni Evropian (2026). *Raporti për Kosovën 2026*. Bruksel: Komisioni Evropian.

McKinsey & Company (2026). *Gjendja e organizatave në vitin 2026*. McKinsey & Company.

Ministria e Financave (2022–2027). *Ligjet për ndarjet buxhetore, projektbuxheti për vitin 2027, raportet e ekzekutimit të buxhetit dhe seritë kohore fiskale të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Ministria e Financave.

OECD (2024). *Perspektiva e Konkurrueshmërisë në Ballkanin Perëndimor 2024: Kosova*. Paris: OECD Publishing.

OECD (2026). *Tabela e treguesve të konvergjencës ekonomike për Ballkanin Perëndimor 2026*. Paris: OECD Publishing.

OECD (2026). *Rezultatet e PISA 2025 (Vëllimi I): Kosova*. Paris: OECD Publishing.

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian (2023). *Rregullorja (BE) 2023/956, e datës 10 maj 2023, për krijimin e Mekanizmit të Rregullimit të Karbonit në Kufij*. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian.

Qeveria e Kosovës (2026). *Projektstrategjia për Migrimin 2026–2030*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (EFTA) (2026). *Marrëveshja e Tregtisë së Lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Kosovës*. Gjenevë: EFTA.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) (2025). *Vendimi për tarifat e energjisë elektrike për vitin 2025*. Prishtinë: ZRRE.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) (2026). *Raporti Vjetor i Auditimit për Vitin Financiar 2025*. Prishtinë: ZKA.

RIINVEST
INSTITUTI PËR HULUMTIME ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH